

## STUDIME DHE ARTIKUJ

*Ukë Xhemaj*

### DISA KARAKTERISTIKA SOCIO-FAMILJARE DHE EKONOMIKO-DEMOGRAFIKE TË KOMUNËS SË ISTOGUT NË MES TË REGJISTRIMEVE TË FUNDIT, 1961—1971

Popullsia është një faktor dinamik, i cili ndryshon shumë shpejt në kohë dhe hapësirë. Prandaj, është vështirë të përcaktohet me përpikni gjendja e masës popullore në momentin e vështrimit, nga se vetë dukuria dinamike e bën relativ atë fakt. Natyrisht se dinamizmi s'mund të jetë i njëjtë në kohë dhe hapësirë, sikundër që është i pamundur zhvillimi proporcional i shoqërisë (e tërë kjo është rezultat i joekuilibritetit të proceseve shoqërore). Atëherë edhe vetë lëvizja e numrit të popullsisë së komunës së Istogut është sinkronizim i shumë faktorëve shoqërorë dhe elementeve natyrore. Trajtimi më i gjerë i kësaj problematike, do të bëhet në kapitujt vijues të këtij punimi.

Shtimi i përgjithshëm demografik i popullsisë së kësaj treve është rezultat i lëvizjeve natyrale dhe mekanike të popullsisë. Këto dy komponente janë gjithnjë prezente në proceset e jetës shoqërore, të cilat njëherit shprehin mvarësinë reciproke të një sere faktorësh ekonomik-shoqërorë, politiko-kulturalë, arësitorë dhe historikë. Mirëpo, ndikimi i tyre nuk është gjithnjë po me atë masë. Secili faktor shoqëror, apo element natyror, intensitetin e ndikimit mbi një dukuri apo proces të jetës shoqërore nuk mund ta ketë të njëjtë në kohë dhe hapësirë. Prandaj, trajtimi i faktorëve dhe elementeve në proceset shoqërore, e sidomos në transformimet dinamike demografike, kërkohet të jetë sa më i freskët, mundësisht i mbështetur në shënimet më të reja statistikore apo në burimet e tjera, pa marrë parasysh natyrën burimore të tyre. Për këtë arsye edhe vetë trajtimi i problematikës në këtë punim do të jetë e orientuar kryesisht mbi shënimet më të reja në regjistrimin e vitit 1961 dhe 1971.

Regjistrimi i popullsisë në vitin 1961, dëshmoi se kjo komunë brenda kufijve administrativë numëronte 33779 banorë. Kjo shifër brenda një dekade u rrit në 41091 banorë. Pra, sipas regjistrimit të vitit 1971 shihet se numri i përgjithshëm është shtuar për 7312 banorë, që do të thotë se i përgjigjet indeksit të shtimit prej 121,4 apo shkallës së shtimit 21,6%.<sup>1</sup>

Ky është një ekspansion demografik i popullsisë, i cili shpreh në mënyrë më të denjë vitalitetin e popullsisë dhe shkallën e biodinamizmit natyral. Njëherit kjo gjendje është edhe shprehje e ligjshmërisë natyrore në rrethana

<sup>1</sup> Enti Krahinor i Statistikës, Regjistrimi i popullsisë — popullsia, familjet dhe banesat sipas komunave dhe vendbanimeve, KSA e Kosovës, Prishtinë, maj 1971. f. 13.

të caktuara ekonomiko-shoqërore, kulturele, politike etj. Mbasi potencojmë ecurinë e lëvizjeve natyrale dhe në përgjithësi demografike të popullsisë në rrethana të ndryshme, atëherë kësaj i shtojmë edhe disa të dhëna statistikore, me të cilat do të sqarojmë gjendjen faktike të supozuar më parë.

Shënimet statistikore vërtetojnë shtimin pozitiv të masës popullore në këtë trevë, qysh në ditë e para pas Luftës së Dytë Botërore, dukuri kjo që është prezente edhe tani. Mirëpo, mbi të gjitha, shkalla e shtimit ka ndryshuar. Kështu, mesatarja vjetore në mes regjistrimit të vitit 1948-1953 arrinte indeksin 112,9, gjersa ajo në mes viteve 1953-1961, 118,3. Këtu kemi të bëjmë me shtimin e popullsisë, si rezultat të rënies së mortalitetit, natalitetit konstant të lartë, e që janë kontribut i gjendjes më të mirë ekonomike, kulturele dhe kushteve medicinale.

Nëse i krahasojmë rezultatet e theksuara më parë, me ato të decenjes së fundit dhe, në mes tyre gjejmë një mesatare relative, atëherë kemi për të veçuar shtimin rapid të popullsisë në masën e përgjithshme demografike, e cila për periudhën 1948-1971, ka arritur indeksin e shtimit prej 167,2.<sup>2</sup> Proporcionalisht me shtimin e numrit të përgjithshëm të popullsisë, është shtuar edhe numri i familjeve. Sipas regjistrimit të vitit 1961, në komunën e Istogut kishte gjithsejt 4877 familje, gjersa në vitin 1971, numri i tyre u shtua për 722 familje (gjithsejt 5649), që i përgjigjet indeksit të shtimit prej 115,8. Pra, nga ky shënim shohim se për të njejtën periudhë numri i përgjithshëm i popullsisë është shtuar për 21,6%, gjersa numri i familjeve për 15,8%. Sipas gjendjes ekzistuese supozojmë se akoma marrëdhëniet patriarkale bëjnë presion mbi ecuritë bashkëkohore drejt formimit të familjes.<sup>3</sup>

Vlen të përmendet se shtimi i përgjithshëm i popullsisë të kësaj komune nuk është i barabartë nëpër grupet etnike. Gjersa ke njëra përkatësi etnike paraqitet ekspansioni demografik i popullsisë, në grupin tjetër etnik paraqitet depopulacioni. Kemi fjalën për popullsinë shqiptare si demografiko-ekspansive dhe ate serbe, malazeze dhe turke depopullore. Dukuria e përmendur është më intensive që nga viti 1961 e tutje dhe, kryesisht është rezultat i lëvizjeve mekanike (emigrimit) dhe natyrale të popullsisë. Por, potencojmë se si shtimi natyral, ashtu edhe shpërnguljet e popullsisë janë duke u bërë në fazën e zhvillimit të lirë social, politik, ekonomik dhe kultural, çka e dallon atë prej periudhave të mëparshme dirigjuese. Ekspansioni biodinamik-demografik i popullsisë, ka shtuar dendësinë e popullsisë, qoftë atë matematikore, agrare apo bujqësore. Shtimi i kësaj shkalle ka shkuar proporcionalisht me shkallën e shtimit të përgjithshëm. Në vitin 1961, në një km<sup>2</sup>, në trevën e kësaj komune jetonin 74 banorë, gjersa gjer në vitin 1971 dendësia u shtua në 93 banorë në 1 km<sup>2</sup>.<sup>4</sup>

<sup>2</sup> Regionalni prostorni plan SAP Kosova, Osnovna studija, Stanovništvo SAP Kosovo, migraciona kretanja stanovništva SAP Kosovo — Analiza i ocena stanja i mogućnosti razvoja. Mars, 1971 Prishtinë, f. 70.

<sup>3</sup> Rezultatet e para të regjistrimit të popullsisë dhe të banesave në vitin 1971, maj, 1971. Prishtinë, f. 13.

Kjo dukuri nuk është prezente në të gjitha fshatrat e kësaj komune; natyrisht është më e dalluar atje ku në familje mbretërojnë marrëdhëniet akoma patriarkale. Këtë e kushtëzojnë vetë rrethanat ekonomiko-shoqërore, historiko-politike dhe arësimore-kulturale. Pra, dukuria në fjalë është më prezente në fshatrat rrëzë maleve, të cilat aktivitetin e tyre ekonomik e kanë të orientuar në bujqësi, prandaj dhe familjet e tyre janë me më shumë anëtarë.

<sup>4</sup> Si në fusnotën 2, f. 76.

Sqarim. Meqë ky regjion është më tepër bujqësor, problem të dendësisë së popullsisë më fort paraqet ajo agrare se sa matematikore, e cila tani ka arritur në 1,69 banorë për 1 ha tokë, apo në sipërfaqet e mbjellura me pemë, vreshta kopshte dhe tokë të lëruar arrijnë në 3,24 banorë për 1 ha. Shënim i shkoqitur si në fusnotën 4, por f. 79.

Mirëpo, shtrohet nevoja që të theksohet dukuria se dëndësia dhe, në përgjithësi shtrirja e popullsisë, nuk mund të jetë e barabartë dhe se as në këtë trevë ajo nuk është e barabartë, nga se atë nuk e bëjnë të mundur si rrethanat ekonomiko-shoqërore, ashtu edhe vetë pozita gjeografike.

Me qëllim që perspektiva të jetë më e qartë në të ardhmen, potencojmë këtë, se ecuria e shpejtë e shtimit të popullsisë në këtë trevë, është kontribut që shton potencialin e fuqisë punëtore, krahas shtimit të dendësisë. Mirëpo, nuk duhet të ekzistojë frika nga stërbanimi, nga se territori i kësaj treve ofron mundësi reale për shtrirje dhe më të dendur. Resurset natyrore, gjithashtu ofrojnë një mundësi të tillë, por duhet pasur gjithnjë parasysh faktin që nëse mungojnë forcat prodhuese dhe zhvillimi intensiv ekonomiko-shoqëror, atëherë çështja e shtimit të popullsisë, dendësia punëtore e painkuadruar, fuqia latente punëtore etj, do të jenë një barierë e pakalueshme dhe problem me karakter më të gjerë ekonomiko-shoqëror. E të dyja këto çështje janë gjithashtu proporcionale, prandaj, nevojitet të shtohet problematika në aspektin e drejtë evolutiv dialektik.

### Karakteristikat demografike të popullsisë

Ngjashëm me qarkullimin e materjes në natyrë, që transformohet, modifikohet dhe prapë ekziston, ashtu edhe popullsia më tepër së çdo faktor tjetër i nënshtrohet momentit modifikues dhe transformimeve intensive si në kohë, ashtu edhe në hapësirë.

Edhe popullsia e kësaj treve është në një rrugë të tillë. Ajo tani më tepër se kurrë më parë gjendet në suazat e transformimit të saj demografik dhe struktural në tërësi. Pra, fjala është për karakteristikat demografike, të cilat janë si rrjedhim i shumë faktorëve ekonomiko-shoqërorë, historiko-politikë, arsimorë-kulturalë, vitalitetit, biodinamizmit dhe komponenteve të tija, si dhe elementeve të shumta të rrethit gjeografik. Meqë secila njësi teritoriale, qoftë edhe prej dy, tre apo edhe më shumë faktorëve, ka veçoritë e saj gjeografike dhe të kaluarën e saj historike të veçantë, me karakteristika dhe rrethana specifike, është e pamundur të ketë ecuritë e njëjta demografike. Prandaj, edhe brenda kufijve administrativë të kësaj komune janë prezente veçoritë specifike të dinamizmit demografik. Pra, nga kjo që u tha më lart është e qartë se edhe vetë dinamika demografike nuk është e barabartë as në kuadër të vetë vendbanimeve.

Si konkluzion të dinamizmit demografik veçojmë:

1. Shkallën e lartë të natalitetit,
2. Mortalitetin në rënje e sipër,
3. Shtimin natyral të lartë (26,4%. 1971),
4. Vitalitetin dhe biodinamikën në nivel.

Natyrisht se shkalla e shtimit demografik nuk është rezultat vetëm i dy komponenteve (të natalitetit dhe mortalitetit), por është edhe i shtimit, varësisht nga shkalla e vitalitetit, fertilitetit, sterilitetit, nupcialitetit, divorcialitetit, strukturës gjinore, moshatare dhe shumë faktorëve të tjerë ekonomiko-shoqërorë.

### Lëvizjet natyrale të popullsisë

Kjo është një dukuri që paraqet lidhjinë e shumë faktorëve dhe, në një farë mënyre sinkronizimin e tyre, duke dhënë si rezultat lëvizjet natyrale. Marrëdhëniet e faktorëve dhe elementeve, mundësojnë përcaktimin e ritmit të lëvizjes natyrale të popullsisë dhe tipet e tij. Përcjellja dhe studimi i ecurive të lëvizjes natyrale të popullsisë është e domosdoshme për njohjen dhe trajtimin e çështjeve demografike, të cilat kontribuojnë për njohjen e proceseve ekonomiko-shoqërore, në një rreth të caktuar gjeografik.

#### a) Nataliteti (lindjet)

Është komponentja e lëvizjes natyrale të popullsisë, e cila shpreh numrin e të lindurve me vlerë relative, në promila ose në përqindje, apo edhe me numra të plotë, absolutë, për periudhën e caktuar. Vlera e një shprehje të tillë quhet *shkallë* e dukurisë.<sup>5</sup>

Më tepër se në të gjitha strukturat e tjera, te kjo komponentë, reflektojnë ndikimin e drejtpërdrejtë, faktorët socio-ekonomikë, psikologjikë, fiziologjikë dhe heterogjeniteti etnik, së bashku me lëvizjet mekanike të popullsisë. Mirëpo, është e pamundur që të bëjmë shkoqitjen e njërit prej tyre dhe të veçojmë prioritetin e tij mbi të tjerët, për dukurinë e dhënë. Faktorët e lartshënuar në këtë trevë kanë shprehur plotësisht ndikimin e tyre ndaj natalitetit. Së pari gjendja ekonomike është reflektuar në një shkallë të lartë mbi këtë komponente. Njëherit, ky është parimi i përgjithshëm jo vetëm për këtë popullatë, por për të gjitha vendet me shkallë të lartë lindjesh. Sa më e lartë që është shkalla e zhvillimit ekonomik, aq më e ulët do të jetë shkalla e natalitetit. Momenti psikologjik, gjithashtu ka një rëndësi të madhe. Në shumë raste popullsia nga frika që do të mbetet pa trashëgimtar apo të lindë më tepër meshkuj (pra, jetë në parakonkludime fantazie), ose që familja e njërit të ketë më shumë meshkuj se sa familja tjetër etj., ndikon mbi shkallën e shtimit të lindjeve. Edhe momentet fiziologjike, apo më mirë të them vitalitetit dhe biodinamika e popullsisë, shtojnë këtë komponente demografike. Më parë përmendëm diferencimin e shkallës së natalitetit, varësisht prej grupeve etnike, që është plotësisht e logjikshme, nga se asnjë grup njerëzish në kohë të caktuar nuk ka po atë ide, e cila të përputhet me atë të grupit tjetër. Planet e jetës së njerëzve për organizimin e jetës, punën në familje dhe jashtë ndryshojnë; atëherë edhe rrethanat ekonomike nuk mund të jenë të barabarta, çka në përgjithësi sjell diferencimin e shkallës së natalitetit. Pasi koha sjell transformime, e prirë prej punës së organizuar nga njerëzit, atëherë si çdo dukuri e modifikuar, ashtu edhe lindjet e njerëzve kanë ndryshuar në periudha të ndryshme, me vlerën e tyre të shprehur në shkallën, të cilën tani po e japim duke u bazuar në shënime statistikore.

Shkalla e natalitetit në periudhën mes viteve 1957-1961 ishte shumë e lartë, kështu që arriti shkallën prej 42,5%. Gjersa në mes viteve 1962-1966 ka zbritë në 37,4%, edhe më e ulët ishte shkalla në mes viteve 1967-1971, vetëm 34,3%.

<sup>5</sup> Dr. Mladen Friganović, *Socialna geografija i stanovništvo svjeta*, Skolska knjiga, Zagreb, 1968, f. 63.

Pas një rënjeje graduale të natalitetit gjer në vitin 1971, e cila edhe është pritur, paraqitet një ngritje momentale, po jo e rastit, por si rezultat i ngritjes së standardit jetësor, dhe, përmirësimit të kushteve higjieniko-medicinale, të cilat me shpejtësi rapide kanë paksuar numrin e rasteve defektive gjatë lindjeve të nënat dhe kështu nataliteti në vitin 1972 arriti shkallën 35,9%.<sup>6</sup> Kështu vjen në konsiderim krahasimi i marrëdhënieve të jetës shoqërore dhe ligjeve natyrore të popullsisë, të cilat janë shprehje e një lidhnie kauzale. Për të qitur në shesh mvarësinë e kësaj komponenteje demografike prej kushteve ekonomike dhe në përgjithësi jetës dhe standardit shoqëror, po përcaktojmë shkallën e natalitetit nëpër katër periudha të shprehura në promila, për tri qendra komunale dhe për mesataren kosovare.

Tabela nr. 1. Shkalla e natalitetit e shprehur në ‰


Territori komunal	Vlefata mesatare vjetore e shprehur në promil <sup>7</sup>			
	P e r i u d h a t			
	1957 — 1961	1962 — 1966	1967 — 1971	1971 — 1972
Istogu	42,5	37,4	34,3	35,9
Leposaviqi	31,3	19,9	16,8	17,6
Suhareka	47,1	47,4	45,7	47,2
Kosova	41,8	40,0	37,2	35,3

Pra, këto shënime janë pasqyra e gjendjes ekonomike nëpër vendet e përmendura për të djeshmen dhe të tashmen e, njëherit shërbejnë si synim për të ardhmen e afërt apo të largët. Megjithatë, gjendja e tashme është vetëm një fazë kaluese, të cilën e kanë përjetuar edhe vendet më të zhvilluara në botë e që do ta tejkalojnë edhe këto vende, kështu që pas një kohe jo fort të gjatë edhe këto vise, tashi të kapluara prej problemit të natalitetit të lartë, do të bëjnë përpjekje për shtimin e kësaj shkalle, ashtu siç po ngjet sot në RS të Sllovenisë apo në KSA të Vojvodinës. Se kur do të vijë ajo kohë, kjo mvaret vetëm prej intensitetit të zhvillimit ekonomik, kultural, arsimor, medicinal etj. etj. Pothuaj vetvetiu faktori ekonomik ka mbetur si më relevanti në radhën e modifikatorëve demografikë, porse ai shpeshherë nuk mund të vijë në shprehje si faktor primar. Atë e zëvendësojnë në shumë raste marrëdhëniet patriarkale. Këtë e justifikon më së miri fakti se popullsia, e cila banon në zonën rrëzë maleve dhe që merret kryesisht me bujqësi dhe blegtori, do të thotë është më e prapambetur dhe e mbyllur ende në lëvozhgën e presionit patriarkal (nuk është rast i përgjithshëm, vetëm raste, të cilat gjithnjë janë më të rralla), e nënshtruar bindjes së të parëve për lindje dhe shtim e tashëgim, përjeton edhe tashi shkallën më të lartë të natalitetit, në krahasim me popullsinë e shkolluar, të arsimuar dhe atë të veprimtarive ekonomike sekondare.

<sup>6</sup> Si në fusnotën 1, por është bërë shkoqitja e shënimeve, shndërrimi i vlerave absolute në relative dhe ndarja e tyre për periudha (nga autori).

<sup>7</sup> Si në fusnotën 6. Gjithashtu plotësim i vlerave relative të shprehura në promila.

Në përgjithësi oscilimet, si në mes komunave apo edhe ndryshimet nëpër periudha, mund të përcillen në grafikun Nr. 1.



Shkalla e natalitetit të popullsisë

#### b) Mortaliteti (vdekjet)

Është komponentja e dytë e shtimit natyral të popullsisë. Ngjashëm me natalitetin, edhe kjo shprehet me vlera relative dhe absolute. Mirëpo në këtë rast kemi të bëjmë me vdekjet e popullsisë. Pra, analoge me natalitetin, shkalla e mortalitetit paraqet numrin e të vdekurve në njëmijë banorë dhe shprehet në promila apo përqindje.

Shkalla e kësaj komponenteje demografike varet drejtpërdrejtë prej nivelit të zhvillimit ekonomik. Respektivisht, varësinë e këtij e gjejmë edhe më të ngushtë te gjendja sociale, kushtet higjeniko-medicinale, niveli i ngritjes profesionale, arsimore dhe kulture. E, gjersa përmendim kushtet dhe faktorët si indikatorë të kësaj komponenteje, atëherë jemi të detyruar të theksojmë së në komunën e Istogut të gjithë faktorët e përmendur ishin prezentë dhe në një shkallë të ulët të zhvillimit. Një gjendje e tillë ishte shprehje e zhvillimit ekonomik, në rrethana të trashëguara historiko-politike të së kaluarës. Në kushte të përmendura u krijua baza e zhvillimit të përgjithshëm, e cila tërhoqi mbeturinat e saj gjer vonë dhe u reflektua në jetën dhe marrëdhëniet shoqërore. Atë gjendje e tregon më së mirë shkalla e lartë e mortalitetit, në tabelën 2.

Tabela nr. 2. Shkalla e mortalitetit e shprehur në promila<sup>8</sup>

Territori komunal	P e r i u d h a t			
	1957—1961	1962—1966	1967—1971	1971—1972
Istogu	13,2	10,6	7,6	7,4
Leposaviqi	8,6	7,5	6,7	6,6
Suhareka	18,2	14,6	10,8	10,4
Kosova	14,0	11,8	8,7	7,9

Nga shënimet tabelare shihet se shkalla e mortalitetit në komunën e Istogut, në vitet e fundit ka zbritur dukshëm. Kjo do të thotë se është bërë një zhvillim i tërësishëm dhe proporcional ekonomik-shoqëror në decenien e fundit, i cili ka zvogëluar shkallën e mortalitetit. Kjo, meqë është e lidhur drejt-përdrejtë (mendohet në mortalitetin) me të gjitha dukuritë apo strukturat shoqërore, atëherë mbetet të marrim në shqyrtim, edhe një moment mjaft të rëndësishëm, i cili për këtë komponente është kushtëzues i rëndësishëm — vitalitetin apo strukturën moshatare të popullsisë. Se sa rëndësi ka ky moment struktural për mortalitetin si komponente demografike, tregon rasti kur bëjmë krahasimin në mes komunës së Istogut dhe KSA të Vojvodinës.

Në vitin 1971, shkalla e mortalitetit në KSA të Vojvodinës ishte shumë e lartë dhe në krahasim me shkallën e natalitetit 13,1‰, ajo arrinte në 10,1‰ që rezulton shtimi shumë i ulët natyral i popullsisë, vetëm 30‰.<sup>9</sup> Në të njëjtën kohë, në komunën e Istogut, shkalla e mortalitetit ishte 6,6‰ kurse ajo e natalitetit 34,3‰.<sup>10</sup> Nga të dhënat shohim shkallën shumë të lartë të mortalitetit në KSA të Vojvodinës, e cila në çdo aspekt është në shkallë më të lartë të zhvillimit, qoftë ekonomik, arsimor, kultural, medicinal etj. nga komuna e Istogut. Pra, në këtë rast shkallën e lartë të kësaj komponenteje nuk e shtoi prapambetja, por struktura moshatare, e vjetër e popullsisë. Vdekja e grupit të popullsisë së shtyrë në moshë, e cila dominon në këtë strukturë, është pasojë e kontrollimit të hershëm të popullsisë. Gjersa në komunën e Istogut biodinamika e re e popullsisë e ka zvogëluar dukshëm këtë shkallë.

Shkallën e kësaj komponenteje demografike në këtë komunë e shton shkalla specifike e mortalitetit infantil. Është shkalla e vdekjeve të foshnjeve, të cilat më së tepërmi u janë nënshtruar kushteve të vështira jetësore, mbikëqyrjes së dobët, veshëmbathjes së dobët, ushqimit jokalorik, kushteve higjenike jo të mira, shërbimit medicinal jo të mjaftueshëm dhe me kohë. Varësisht prej kushteve të përmendura, shkalla e mortalitetit ndryshon nëpër fshatra dhe nëpër grupe etnike të popullsisë. Në mungesë të shënimeve nuk mund të pasqyroj gjendjen nëpër fshatra.


<sup>8</sup> Si në fusnotë 7.

<sup>9</sup> Dr. Dragan P. Rodić, *Geografija Jugoslavije za IV razred gimnazije*, Beograd 1973, f. 58.

Tendencja e një lëvizjeje të tillë në Vojvodinë çon drejt depopulacionit, mungesës së potencialit të fuqisë punëtore, paraqitjes së imigrimit etj. Komuna e Istogut në këtë aspekt qëndron në bazë të fortë.

<sup>10</sup> Enti Krahinor i Statistikës, Regjistrimi i popullsisë, viti 1971, f. 43.

Trendin e kësaj komponenteje më së miri e paraqet grafikoni Nr.2.



Shkalla e mortalitetit të pupullsisë

### Shtimi natyral i pupullsisë

Rezultati në mes dy komponenteve të mëparshme, i dhënë me vlefte relative apo absolute, paraqet shtimin natyral të pupullsisë. Këtë e rezultojnë të gjitha rrethanat dhe faktorë te komponenteve të mëparshme, të natalitetit dhe të mortalitetit, të gërshtëuara dhe të varura reciprokisht. Prandaj, krahas ecurive labile, shkallës së lartë apo të ulët të komponenteve të mëparshme, edhe shtimi natyral nuk ka qenë stabil për të njëjtën periudhë, por ka pësuar një trend të ngjashëm me këto komponente. Këtë lëvizje e bën më të qartë e dhëna statistikore në tabelën Nr. 3.

Tabela nr. 3.<sup>11</sup> Shtimi natyral i popullsisë i shprehur në ‰

Territori komunal	P e r i u d h a t			
	1957—1961	1962—1966	1967—1971	1971—1972
Istogu	29,3	26,8	26,7	—
Leposaviqi	22,7	12,4	10,1	—
Suhareka	28,9	32,8	34,9	—
Kosova	27,8	28,2	28,5	27,4

Mbi të gjitha, shkalla e shtimit natyral është ende shumë e lartë. Ky fakt njëherit është dëshmi e gjendjes së tashme të zhvillimit ekonomik dhe të marrëdhënieve demografike të popullsisë. Analiza e kësaj ecurie na shpie drejt të vërtetës se kjo komunë ka një potencial të madh të fuqisë punëtore dhe se kontigjenti i fuqisë punëtore është duke u shtuar gjithnjë e më tepër, proporcionalisht me shtimin e popullsisë dhe vitalitetin e biodinamikën e saj. Por, kjo dukuri, për gjendjen e tashme të zhvillimit ekonomik, ku potenciali i fuqisë punëtore nuk është manifestuar për inkuadrim të plotë dhe shfrytëzimin e kapaciteteve të punës, shkakton probleme në politikën e inkuadrimit dhe të ndarjes së punës. Sidomos tashi problemet janë më të mëdha, kur mundësitë e inkuadrimit janë më të vogla se sa potenciali i fuqisë punëtore. Këtë problem e ashperson edhe më tepër fuqia latente punëtore, e cila këtu është prezente në një masë të gjerë. Pasojat e shtimit natyral, ku zhvillimi ekonomik nuk është në shkallën e duhur, janë edhe më të mëdha dhe me karakter të ndryshëm. Kështu, si pasojë e tij shkaktohen lëvizjet mekanike të popullsisë, emigrimi i fuqisë punëtore brenda dhe jashtë vendit. Si rrjedhim i këtij emigrimi është prishja e strukturës ekonomike, e potencialit të fuqisë punëtore, e vitalitetit të popullsisë, e biodinamikës, e nupcialitetit (kurorëzimit), e divorcialitetit (çkurorëzimit) dhe prishja e harmonisë familjare, qoftë në edukimin e fëmijëve apo në jetën e përbashkët familjare.

Siç shihet prej një procesi eksploziv demografik në rrethana jo të nivelizuara me zhvillimin ekonomik-shoqëror, rrjedhin të gjitha këto probleme, të cilat në e parë nuk bien në sy. Kjo etapë e zhvillimit të tashëm demografik është vetëm një periudhë momentale, e cila, natyrisht, është shprehje e rrethanave ekonomik-shoqërore. Duke u bazuar në gjendjen faktike dhe ligjin e evolimit demografik, mund të pohojmë se popullsia e kësaj komune gjendet në fazën e transicionit demografik,<sup>12</sup> i cili përcjell popullsinë në këto kushte të zhvillimit.

<sup>11</sup> Po aty, fusnota 7.

<sup>12</sup> Transicioni demografik është një periudhë e ecurive demografike, e cila paraqitet te popullsia e atyre viseve që e kanë kaluar periudhën e shtimit biologjik (në të cilën paraqitet shtimi i vogël i popullsisë, si rezultat i natalitetit fiziologjik dhe mortalitetit shumë të lartë) dhe tash gjenden në fazën e zhvillimit ekonomik më të lartë, ku kushtet jetësore dhe stantardi më i lartë jetësor kanë ndikuar në shtimin më të madh të popullsisë nga se mortaliteti tash është dukshëm më i ulët, dhe, edhe më tutje shkon drejt uljes. Këtë transicion demografik, në literaturën e gjerë demografike e hasim edhe me termat: „epoka demografike”, „ekspansioni demografik”, „periudha kalimtare” etj.

Pra, theksuam se kjo është një periudhë kalimtare, ligjshmëri e jetës demografike, e cila me siguri do t'i humbë veçoritë e tashme, krahas transformimeve, të cilat janë duke u bërë në zhvillimin e përgjithshëm shoqëror. Poqese në kushte të tashme do të zhvillohej edhe më tutje procesi demografik, atëherë numri i popullsisë së kësaj komune në vitin 2 000 do të ishte 90.000 banorë. Gjersa në bazë të llogaritjeve sipas shtimit të tashëm, prej 26,7‰ (1971), numri i banorëve do të arrijë në 45.500 në vitin 1975. Kjo do thotë se, sikur shkalla e shtimit të mbetet konstante rreth 27,0‰, atëherë popullsia e kësaj komune do të arrijë dyfishin e banorëve pas 25 vjetëve.<sup>13</sup> Andaj, kur gjendjes faktike i shtohet edhe supozimi i theksuar për shtimin demografik, shtohet pesimizmi për problematikën, të cilën ka për ta sjellë perspektiva e ardhshme demografike. S'do koment se në këtë rast situatës momentale dhe asaj që paraqet perspektivën e së ardhmes për të zgjidhur këtë çështje, mund të na ndihmojë vetëm shpërdarja proporcionale e popullsisë nëpër degët ekonomike (proporcionalisht me nevojën dhe kërkesat perspektive të degëve ekonomike, si në rreth të ngushtë komunal, ashtu edhe në atë krahinor, republikan dhe shtetëror), pastaj politika e drejtë e inkuadrimin, e të gjitha këto të vihen në proporcion me kontrollimin e lëvizjes natyrale të popullsisë, e cila faktikisht do të jetë si rezultat i proceseve ekonomiko-shoqërore në përgjithësi.

Këtu është nevoja të potencohet disproporcioni i shtimit të përgjithshëm demografik të popullsisë nëpër grupe etnike dhe në mes të vendbanimeve. Diferencimi i shtimit në mes të grupeve etnike do të trajtohet veçmas dhe detalisht në strukturën nacionale të popullsisë.

Regjistrimi i fundit i popullsisë (1971) qiti në shesh shtimin rapid demografik, atë normal dhe depopulacionin, nëpër fshatrat e kësaj komune. Bie fjala, indeksi i shtimit në fshatin Zhakovë zbrit nën konstante, 97,6, gjithashtu Veriqin e Ri arrin minimumin 22,7, pastaj në Kërrninë 89,1, në Suhogërlle 92,9, në Llukavc të Thatë 96,4 dhe në Dobrushë 97,3.<sup>14</sup> Kjo dukuri është si rezultat i shtimit të ulët demografik dhe i procesit të madh emigrues. Përkundër procesit depopulativ, nëpër fshatrat e përmendura paraqitet grupi i dytë i vendbanimeve me transicion të vërtetë demografik. Shtimin më të madh gjatë kësaj decenie e arritën këto fshatra: Banja (indeksi i shtimit 153,9), Dubrava (145,9), Cërrolluka (143,9), Zabllaçi (141,3), Trubuhovci (140,4) etj.<sup>15</sup> Ndikimet e komponenteve në bilancin e përgjithshëm demografik dhe pastaj karakteristikat diferencuese si në kohë, ashtu edhe në hapësirë, më së miri i kemi veçuar në grafikun Nr. 3.

Për të dhënë në mënyrë sa më të qartë procesin e lëvizjeve natyrale dhe në përgjithësi shtimin natyral të popullsisë, është e nevojshme të theksohen edhe disa momente të tjera, të cilat në shumë raste kushtëzojnë komponentet


<sup>13</sup> Dr. Mladen Friganović, *vepra e cituar* f. 220, (shënim tabelar).

<sup>14</sup> Enti Krahinor i Statistikës, *vepra e cituar* f. 14.

Në këtë rast bie në sy se popullsia e fshatrave të përmendura, të të cilat paraqitet depopulacioni, i perket përkatësisë serbe. Shkaku është shtimi i ulët natyral — kontrollimi i familjeve dhe më tepër emigrimi. Emigrimi është si rezultat i momentit psikologjik që nxit në mënyrë lakmuese popullsinë për një jetë më të mirë dhe të lumtur në vendin e rivendosur. Do thotë, janë rryma emigruese të vetëdëshiruara, të lira, pa presion ekonomik apo politik, çka i dallon prej emigrimeve të paraluftës.

<sup>15</sup> Rezultatet e para të popullsisë së regjistruar me 1971, për familje dhe banesa sipas komunave dhe vendbanimeve, KSA Kosovës, EKS, Prishtinë maj 1971, f. 14.

demografike të shtimit natyral. Fjala është për: fertilitetin (plleshmërinë), sterilitetin (shterpsimin, paaftësinë për shtimim biologjik), nupcialitetin (kuro-rëzimin) dhe divorcialitetin (çkurorëzimin). Në këtë radhë nuk numëruam edhe strukturën moshatare dhe atë gjinore, për to do të bëhet fjalë posaçërisht.



Shtimi natyral i popullsisë 1957 — 1972

Për fertilitetin mund të thuhet të paktën ajo që është thënë për natalitetin, pra, edhe atë e kushtëzojnë elemente dhe faktorë të ngjashëm, kurse steriliteti është pasojë e shumë rrethanave ekonomiko-shoqërore. Jeta me mundime fizike, ekonomike, sëmundje të hershme — në fëmijni, çrregullimet e organeve gjenitale etj. janë faktorët kryesorë që shtojnë numrin e rasteve të tilla. Numri relativisht i madh i rasteve të martesave në moshë të re dhe divorcialiteti i ulët shprehen pozitivisht në shkallën e shtimit demografik.

Në fund theksojmë se shtimi natyral i popullsisë është në rënje e sipër. Pritet që brenda dy decenieve shkalla e tij të jetë dukshëm më e vogël; ai do të hyjë në fazën e shtimit konstant-stabil që me siguri në të ardhmen më të largët e pret edhe depopulacioni.

### Struktura gjinore

Shikuar parimisht në këtë strukturë kuptojmë relacionin numerik në mes gjinisë mashkullore dhe asaj femërore. Zakonisht, kur shikohet në aspektin natyral, rrjedha e këtij relacioni është relativisht afër balancimit, por, është e pamundur të gjendet ndonjë rast, ku do të përputhej plotësisht numri i meshkujve me atë të femrave. Qysh në vështrimin e parë të kësaj strukture del në pah problemi se mosekuilibriteti i kësaj strukture, ka për të lënë pasoja në shumë procese të tjera, të cilat më vonë do kenë si rrjedhim disharmoninë në shumë procese shoqërore, e ndoshta edhe në veprimtaritë ekonomike. Këtu duhet të veçojmë edhe atë se me këtë strukturë në shumë raste mund të bëjmë përcaktimin e karakteristikave fiziologjike në suazat e masës demografike.<sup>16</sup>

Si gjetiu, në komunat e tjera të Kosovës, ashtu edhe në komunën e Istogut, kjo strukturë nuk është në harmoni të plotë gjinore, në aspektin numerik. Më i madh është numri i meshkujve se sa i femrave për plot 2,6%, apo proporcionalisht, marrë 1 000 femra bien 1 005 meshkuj.<sup>17</sup> Prandaj, diferencimi struktural dhe rëndësia e tij imponojnë një vështrim detal studjues.

Mosbarazimi numerik i kësaj strukture ushtron ndikime të shumta mbi shumë aspekte demografike si:

- ndikimin negativ mbi shkallën e nupcialitetit,
- strukturën moshatare,
- shkallën e fertilitetit dhe të natalitetit,
- shtimin e madh të kontigjentit punues mashkullor dhe
- përzierjen e strukturës nacionale.

Kuptohet se kjo e fundit është bërë me rastin e martesave në mes të grupeve të ndryshme etnike. Zakonisht, raste më të shpeshta në këtë dukuri ka pasur te popullsia shqiptare, e cila shpeshherë është martuar me popullsinë e përkatësirave nacionale serbe dhe malazeze. Nga ky rast, nxjerrim në shesh edhe një dukuri, është fjala për strukturën gjinore në këto grupe etnike, e cila sipas këtij rasti e bën të ditur së kjo strukturë është në favor të gjinisë femërore.

Përveç martesave, të cilat janë bërë apo akoma bëhen në suazat e kësaj treve, në mes të grupeve etnike, ka raste ku një numër njerëzish është shpërngulur vetëm për shkaqe martesë edhe jashtë territorit kumunal apo krahi-nor. Pra, këtu zë fill miniemigrimi si poces i jetës shoqërore. Prandaj, duke pasur parasysh vetëm disa momente më të rëndësishme të kësaj strukture, për shoqërinë e kësaj treve, vumë në pah rëndësinë e saj, e cila është shumë e madhe dhe që lë vazhdë në proceset shoqërore të kësaj popullate.

Rasti i tillë i strukturës gjinore në këtë komunë nuk është i vetmi. Ajo është dukuri për tërë Kosovën dhe jashtë asaj, gjithkund ku edukimi dhe, në përgjithësi marrëdhëniet shoqërore, kanë qenë apo ende janë të mvëshura me petkun patriarkal. Por, gjithashtu duhet pasur të qartë edhe faktin se ngulmi i dikurshëm i marrëdhënieve patriarkale, tashmë i shtyrë prej së resë bashkëkohore, po humb gradualisht gjurmët e veta në popullsinë e kësaj treve si dhe gjetiu.

<sup>16</sup> Si në fushn. 13. *vepra e cituar*, f. 84.

<sup>17</sup> Rezultatet e fundme për popullsi dhe për ekonomitë familjare sipas komunave, për vitet 1961, 1971, f. 47. Shtojcë autori.

Momenti i ekukimit patriarkal, për të cilin nuk ekziston masë për matjen e shkallës së tij, e shprehur me shifra, i shkoqitur vetëm prej kësaj strukture shoqërore, po del se ka qenë më prezent te popullsia shqiptare. Sidomos ka qenë karakteristike epërsia dhe prioriteti i gjinisë mashkullore ndaj asaj femërore. Fëmija i lindur mashkull te popullsia shqiptare, sipas botëkuptimit të saj, ka qenë më i vlefshëm. Është konsideruar si trashëgimtar i familjes, i oxhakut, i cili ka kryer punët fizike dhe mendore, ka mbajtur shtëpi (gjersa femra është konsideruar si „rob” i derës së huaj, e cila pak ose fare nuk kontribuon në familjen e prindërve). Mirëpo, këtu nuk duam dhe as që kemi për qëllim të veçojmë popullsinë shqiptare për marrëdhënie të tilla, sepse te të gjitha grupet tjera etnike, kjo fazë ka qenë apo është ende prezente, dhe ka pasur apo ka të njëjtin karakter edukativ për shoqërinë. Këtu zë fillin disproporcioni struktural në mes të gjinive. Veçmas është interesante kjo dukuri nëse përcillet nëpër grupet moshatare, shih tab. nr. 4.

Tabela nr. 4.<sup>18</sup> Popullsia sipas gjinisë dhe moshës për vitin 1971

Vendi	G r u p e t m o s h a t a r e									
	Gjinia	Gjithësejt	0—4	5—9	10—14	15—19	20—24	25—29	30—34	35—39
I S T O G U	M	21033	3473	3072	2739	2222	1739	1136	1230	1095
	F	19976	3276	2782	2486	2012	1513	1123	1199	1213
	Gjith.	41009	6749	5854	5225	4234	3252	2259	2429	2308


Gjinia	40—44	45—49	50—54	55—59	60—64	65—69	70—74	mbi 75 vjeç.
M	918	590	567	607	570	414	277	269
F	966	641	586	549	506	391	312	312
Gjith.	1884	1231	1153	1156	1076	805	589	581

Këtu po theksojmë se prej numrit të përgjithshëm të popullsisë të grupit moshatar 20-35 vjeç (d.m.th. është përfshirë popullsia që gjendet në suazat e biodinamikës më të madhe demografike, pra ajo e periudhës së fertilitetit maksimal) një balancim numerik në mes dy gjinive të këtij grupi moshatar. Këtë e vërteton e dhëna se 50,7% e popullsisë, së këtij grupi moshatar janë meshkuj, gjersa 49,3% janë femra. Këtu qëndron e mira e kësaj strukture, e cila më vonë reflektohet në shumë procese të jetës shoqërore dhe të momenteve demografike. Meqë ky grup njerëzish paraqet bazën stabile të biodinamikës demografike-masën e cila ndikon më së tepërmi mbi shkallën e shtimit naty-

<sup>18</sup> Popis Stanovništva i stanova 1971. Osnovne strukture stanovništva i domaćinstava po opštinama, Beograd, korrik 1972. f. 26. Shënimet tabelare janë plotësuar me të dhënat për gjininë femërore, të shkoqitura prej rubrikës së tabelës: gjithsejt dhe meshkuj.

ral të popullsisë, atëherë disharmonia strukturale, si ajo e përgjithshme e popullsisë apo ajo nëpër grupe moshatare, nuk mund të ndikojë në masë të gjerë mbi kontinuitetin demografiko-social.

Në numrin e përgjithshëm të popullsisë dallimi në mes këtyre dy gjinive është edhe më i madh, 51,4% të popullsisë janë meshkuj, gjersa 48,6% janë femra. Përkundër numrit më të vogël të femrave në strukturë, jeta mesatare e tyre në krahasim me meshkujt është më e gjatë. Këtë e vërteton fakti se mbi moshën 74 vjeçare, 62,4% janë femra. Kjo dukuri ka vënë në dilemë studjuesit e kësaj problematike; jeta mesatare është më e gjatë te femrat, në këtë trevë, ku ajo gjer vonë ishte e paemancipuar, në kushte sociale më të vështira se mashkulli, e pangritur në pikëpamje arsimore dhe kulturele etj. se sa te meshkujt, për të cilët kishin një mbikëqyrje të veçantë, sidomos në moshën fëmijore. Kjo ngjet kështu nga se femra është e liruar prej punëve më tepër se sa meshkujt, kusht, pra, ky qënësor për shtimin e mesatares. Jeta mesatare e femrës në përgjithësi shtohet te popullsia serbe dhe malazeze, sepse femra e këtyre grupeve është në pozitë më të mirë në krahasim me at shqiptare apo grupeve të tjera etnike. Merrëdhëniet e strukturës gjinore të vëna në krahasim në mes gjinive e të shprehura në % mund të përcillen më së miri në piramidën Nr.1.



Struktura gjinore e popullsisë sipas grupeve moshatare në vitin 1971

Situatën më të pavolitshme e hasim te grupi moshatar prej 0 gjer në moshën 19 vjeç, e cila është në dobi të gjinisë mashkullore. E njëjta gjë ngjet edhe me grupin moshatar 20-39 vjeç, por më pak të dalluar. Rast të veçantë paraqet grupi moshatar 40-59 vjeç, te i cili numri i femrave është më i madh se sa i meshkujve për afro 1%. Dukuria në fjalë është si rrjedhim i faktit se popullsia e këtij grupi moshatar u përket gjeneratave që kanë lindur gjatë Luftës së Parë Botërore dhe pas saj, e të cilat kanë bartur tërë peshën e transformimeve sociale-ekonomike dhe politike në mes dy luftërave dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore. E, kuptohet, se gjinia mashkullore ishte e ngarkuar më

së tepërmi me të gjitha problemet që i shtroi jeta dhe nevoja, prandaj, e goditur nga barra e rëndë e kësaj periudhe, pësoi humbje në çdo aspekt, në njerëz, në aspektin psikik, material etj. Pra, është e kuptueshme edhe pjesëmarrja më e madhe e femrave në këtë grup moshatar.

### Struktura moshatare

Rëndësia e kësaj strukture për popullsinë apo për transformimet demografike, biodinamikën popullore, qoftë edhe për ndikimin e saj mbi kontingjentin e fuqisë punëtore, është shumë e madhe.

Ngjajshëm me të gjitha strukturat e tjera popullore, të cilat kanë bazën në disa faktorë apo elemente shoqërore që kalitin konstruktin e saj, ashtu edhe struktura moshatare, varet prej shumë strukturave që lozin rol në këtë drejtim. Faktorët që kanë rëndësi primare për këtë strukturë janë: shkalla e shtimit natyral, pastaj luftërat dhe lëvizjet mekanike të popullsisë (migracionet). Pra, pasi biodinamika është në nivel, atëherë edhe struktura moshatare është në favor të moshës së re. Prandaj, aty për aty del në shesh ndikimi reciprok edhe i vetë strukturës moshatare mbi biodinamikën e popullsisë. Sa më e re që të jetë popullsia, aq më e lartë do të jetë edhe shkalla e vitalitetit. Me këtë popullsia e komunës së Istogut qëndron shumë mirë nga se më tepër se 52% e popullsisë është më e re se 19 vjeç.

Për të pasur më të kuptueshme vetë lëvizjet e strukturës moshatare, qoftë nëpër grupe moshatare më parë, ne, popullsinë e kësaj treve e ndajmë në pesë grupe të mëdha, të cilat i paraqet më së miri shënimi në tabelën nr. 5.

Tabela nr. 5.<sup>19</sup> Popullsia e shprehur në %, sipas moshës dhe periudhës së lindur

Periudha e lindjes	%	M o s h a
Para Luftës së I Bot.	10,2	mbi 55 vjeçare
Gjatë " " " "	3,2	50—55 " "
Mes dy luftërave bot.	19,1	30—55 " "
Gjatë Luf. II Botërore	5,5	25—30 " "
Pas Luf. II Botërore	62,0	0—25 " "
Gjithsejt . . . . .	100,0	

Vetë historiku i kohës dhe ngjarjet në të gjer në mbarimin e Luftës së Dytë Botërore kanë penguar shtimin natyral dhe prishjen e strukturës moshatare. Duke u bazuar në të dhënat statistikore shohim se përmirësimi i strukturës moshatare ka filluar menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore. Këtë e

<sup>19</sup> Enti Krahinor i Statistikës, Rezultatet e fundit për popullsi dhe për ekonomitë familjare sipas komunave për vitet 1961, 1971, Prishtinë, 1974, f. 29, 30, 31. Shënimet janë të përpunuara.

arsyeton vetë shtimi natyral, i cili mesatarisht gjer në vitin 1953 ka arritur shkallën prej 24,2%,<sup>20</sup> për çdo vit. Për të dhënë skeletin sa më të qartë të kësaj strukture, po e ndajmë në tri kategori moshatare të masës demografike (shih shënimin në tabelën nr. 6).

Tabela nr. 6.<sup>21</sup> Ndarja e popullsisë sipas grupeve moshatare dhe kategorive

Kategoritë populative	Mosha	Përqindja (%)
Popullsia e re	gjer 19 vjeç	53,9
Popullsia e pjekur	prej 20—59 "	39,1
Popullsia e moshuar	mbi 60 "	7,0
Gjithsejt . . . . .		100,0

Tash më është krejtësisht e qartë se popullsia e kësaj komune është e re. Në të dominon rinia gjer në moshën 19 vjeç me afro 54,0% të popullsisë së përgjithshme. Kjo do të thotë se vitaliteti është i lartë dhe biodinamika ekspansive. Ky është kompensimi i natalitetit të ulët gjatë Luftës së Dytë Botërore si dhe në tërësi i shkallës së ulët të shtimit natyral, i cili është kompensuar për një kohë relativisht të shkurtër. Në saje të biodinamikës demografike eksplozive, kjo popullatë jo vetëm që i shmanget mplakjes, pastaj depopulacionit, rrezikut të imigrimit, mungesës së fuqisë punëtore etj., por, përkundrazi, në të gjitha këto aspekte është e favorizuar. Pos këtyre momenteve, që i përmendem tash si anë pozitive të kësaj strukture e që ishin si rezultat i freskisë në aspektin demografik, nga ato rezulton edhe një problem i natyrës mekanike — emigrimi si rezultat i fuqisë së tepërt punëtore, e cila nuk ka mundësi të inkuadrohet në vend, e është rezultat i shkallës së lartë të shtimit demografik. Çështja është edhe më akute dhe me pasoja kur dihet se emigrimi bëhet më tepër nga rradhët e popullsisë që është e re, më e afta për punë.


Derisa kemi pasur punë me klasifikimin e strukturës moshatare nëpër grupe të mëdha apo të vogla dhe, pasi që e kemi krahasuar at me shkallën e shtimit natyral, i cili ishte jo i barabartë nëpër grupe etnike, atëherë mund të shtojmë edhe faktin se edhe shpërndarja e popullsisë nëpër grupe moshatare, për nga nacionalitetet e ndryshme, nuk është e barabartë. Lindja e mosbarazisë moshatare nëpër nacionalitete është e qartë dhe plotësisht e kuptueshme. Ajo është si rrjedhim i proceseve demografike, të cilat zhvillohen në kushte të ndryshme shoqërore gjatë historisë. Mungesa e të dhënave statistikore nuk na jep mundësi të trajtojmë më hollësisht këtë problem struktural.

Pos të tjerave, të dhënat statistikore, si një element relativ dhe aproksimativisht i sakët, ofrojnë mundësinë për përcjelljen e grupeve strukturale. Në klasifikimin e përgjithshëm veçojmë se tendenca strukturale moshatare

<sup>20</sup> Po aty, f. 19.


<sup>21</sup> Po aty, f. 29, 31.

e popullsisë së kësaj strukture është edhe më tutje një freskim biodinamik, shtimi i përqindjes së popullsisë rinore në atë të përgjithshme. Këto lëvizje, të vëna në krahasim me ato të komunës së Lepsaviqit, vërehen më së miri në piramidën Nr. 2.



Istogu

Lepsaviqi




Struktura moshatare e popullsisë së komunës së Istogut dhe Lepsaviqit në vitin 1971

Pra, vërehet se, gjersa në komunën e Istogut shihet tendenca gjithnjë më e madhe e përmirësimit të kësaj strukture, në atë të Lepsaviqit ngjet e kundërta, prishja e marrëdhënieve strukturale, kuptohet në aspektin e vjetërsisë intensive të popullsisë, dhe gradualisht dominon masa e vjetër ndaj asaj së resë. Këtë dukuri në komunën e Lepsaviqit e shkaktojnë dy faktorë: 1. Shkalla e ulët e shtimit natyral dhe 2. Emigrimi, kryesisht i popullsisë së re. Nga të gjitha të dhënat e gjertanishme mund të shkoqim si krakteristika të veçanta dhe shumë të rëndësishme për këtë komunë:

- dominimin e popullsisë rinore me 53,9%,
- kapacitetet e mëdha të kontigjentit punues, si rrjedhim i fuqisë punëtore nga popullsia e grupit të moshës 20-59 vjeç, e cila përbën më se 40% të tërë popullsisë,

- zvogëlimin gjithënjë e më të madh të popullsisë së vjetër,
- rritja intensive e numrit të popullsisë së re, e cila përfshihet në shkollim të obliguar. Në vitin 1971, 25% nga e tërë popullsia e kësaj treve ishte e përfshirë në shkollim të obliguar, gjersa 20%, prisnin vijimin fillestar,




Struktura moshatare dhe ndryshimi i saj si dhe tipi i saj për vitet 1961 — 1971

- perspektiva e shtimit intensiv biodinamik është shumë e mirë, nga se 33,8% të tërë popullsisë, në vitin 1971, i takonte periudhës fertile, do të thotë moshës 15-49 vjeç.
- indeksin e mplakjes së popullsisë relativisht të vogël, 0,13,
- zvogëlimin gradual të numrit të popullsisë nëpër grupet moshatare pesëvjeçare, duke filluar prej moshës 40 vjeç e më tutje dhe
- bazën stabile demografike që premtion ekspansion popullativ.

Baza popullore e kësaj treve, e orientuar në biodinamikën ekspansive, është garancion i stabilitetit afatgjatë të masës demografike-strukturale, moshatare. Të gjitha rrethanat, të cilat i përmendëm si kushtëzues për këtë strukturë, janë paraqitur në mënyrë grafike në piramidën nr. 2., të cilat njëherit

kanë krijuar një gjendje të tillë strukturale; gjersa lëvizjet e kësaj strukture tash për tash dhe kuptimin e lëvizjes së saj në të ardhmen mund të përcjellim në grafikun trigonometrik nr. 4. Pra, ndikimet reciproke strukturale për karakteristikat demografike të popullsisë janë kauzale dhe varen njëra prej tjetrës. Prandaj edhe ecuritë e tyre janë disi të harmonizuara, të cilat reflektohen drejtpërdrejt mbi popullsinë, kështu që nga ato rrjedhin edhe shumë rezultate pozitive apo probleme me të cilat gërshetohet drejtpërdrejt ekonomia e kësaj komune si dhe vetë organizimi shoqëror. Atëherë mu nga kjo jemi të shtyrë të veçojmë disa momente që janë si rezultat i kësaj strukture e që lidhen me proceset e jetës shoqërore.



Kemi thënë se potenciali i fuqisë punëtore do të jetë gjithnjë e më i madh. Atë do ta shtojë në të ardhmen rinia, e cila tash për tash është në shkollim e sipër dhe nën kujdes apo një masë e fuqisë punëtore latente. Mirëpo, prapë këtë perspektivë të kontigjentit punues për të ardhmen jo të largët, kjo komunë është e detyruar ta presë në mënyrë më të përgatitur, qoftë me hapjen e vendeve të reja pune, me shpërndarjen e saj nëpër veprimtari ekonomike sipas sektoreve më perspektivë për zhvillimin ekonomik me zhvillimin e tërësishëm ekonomiko-shoqëror. Përndryshe, nëse nuk do të bëhet një orientim i tillë dhe, poqese ekonomia nuk do të mundet të absorbojë fuqinë punëtore, e cila edhe tash është

jashtë procesit prodhues, atëherë do të paraqiten probleme të ndryshme dhe mjaft të rrezikshme për ekonominë e kësaj komune. Pra, ky është korelacioni në mes popullsisë dhe strukturave të saja, i drejtpërdrejtë me zhvillimin shoqëror në përgjithësi.

Në mungesë të harmonizimit reciprok në mes të strukturës në fjalë dhe zhvillimit ekonomik-shoqëror, mbetet të supozojmë se në të ardhmen do të paraqitet edhe një rrymë emigruese e fuqisë punëtore, e që është me karakter thjeshtë ekonomik. Vërshimi i fuqisë së re punëtore do të jetë i orientuar drejt veprimtarive ekonomike të sektorit të dytë-sekondar (veprimtari industriale, ndërtimore dhe xehtare). Këtë orientim të fuqisë së re punëtore e bën vetë ngritja profesionale e profileve të caktuara, e cila ishte në decenien e fundit orientim kryesor i popullsisë, për këto veprimtari, menjëherë pas arsimit.

Caqet e kufizimit regional për inkuadrim në organizatat prodhuese të kësaj komune, do të tejkalohen. Fuqia punëtore nuk do të jetë më flija e papunësisë në territorin e ngushtë komunal. Kërkesa e madhe e organizatave punonjëse brenda dhe jashtë krahine apo në vend dhe jashtë tij, është një moment që vë në lëvizje emigruese grupet e reja, të papunë, të kësaj komune. Faktin se pjesa më e madhe e popullsisë punëtore, e emigruar përkohësisht jashtë vendit dhe e inkuadruar përkohësisht në punë, është e re, e vërteton e dhëna se prej gjithë masës së përmendur 91,8% i takojnë popullsisë prej moshës 20-44 vjeç.

Në pika të shkurtëra është përfshirë problematika që rrjedh nga struktura moshatare. Megjithëse problematika e kësaj strukture është afatgjate, krahas me zhvillimin ekonomik-shoqëror, kjo do të jetë gjithnjë shkaktare e disa dukurive demografike, ekonomike të migrimit dhe të momenteve të inkudrimit.

### **Struktura ekonomike e popullsisë**

Se sa ka rëndsi studimi i kësaj strukture, është parë nga numri i madh i studimeve që janë bërë në këtë fushë. Prandaj, sado që të ndalemi në këtë punim, për t'i rrahur problemet, të cilat rrjedhin apo i krijojnë kjo strukturë, prapëseprapë nuk mund të qesim në shesh të gjitha fshehtësitë e kësaj strukture që i atribuohen kësaj treve. Kjo, tash për tash, si një çështje kyçe, mbetet e paratruar në veçanti, nga se natyra e këtij punimi është e një fushe më të gjerë dhe e përgjithshme, duke përfshirë problematikën popullore demografike dhe ekonomike të shikuar varësisht nga ndryshimet në kohë dhe hapësirë.

Pasi dinamika e zhvillimit të përgjithshëm të kësaj komune ka qenë me karakteristike gjatë decenies së fundit, edhe vështrimi i studimit është orientuar kryesisht në këtë periudhë.

Dinamizimi bashkëkohor i zhvillimit shoqëror ka dhënë një impuls për një tempo më të shpejtë drejt transformimit të të gjitha lëmenjve të jetës shoqërore. Por, ende intensiteti i të arriturave ekonomik-shoqërore këtu po ngec prapa kohës. Në bazë të të dhënave statistikore të regjistrimit të fundit të popullsisë, shohim se kjo komunë është ende e prapambetur pothuaj në cilindo aspekt që të merret. Ndonëse me këtë supozim situata duket drastike, prapëseprapë

fakti si dëshmi nuk na lejon të jemi optimistë të rastit. Këtë e vërteton më së miri regjistrimi i vitit 1971, me të cilin rast është konstatuar se 77,0% e popullsisë merret me bujqësi, apo 32,6% e popullsisë është analfabete, qoftë fakti tjetër edhe më dëshprues kur mbi 72,0% e popullsisë është e mbajtur — parazitë.

Ecuria ka qenë mjaft solide gjatë decenies së fundit, marrë në tërësi, për zhvillimin e kësaj treve. Shumë ngadalë është përmirësuar gjendja e strukturës së popullsisë agrare. Ajo, siç pamë, është ende dominuese. Në krahasim me vitin 1961, ku arrinte shkallën pre 84,5%<sup>22</sup> deri në vitin 1971 shkalla e kësaj strukture është zvogëluar vetëm për 7,5%, pra minimumi i mundshëm. Mirëpo, krahas me zvogëlimin e pjesëmarrjes së popullsisë bujqësore në numrin e përgjithshëm të popullsisë, vërejmë një stagnim apo ngecje në përmirësimin e pjesëmarrjes së popullsisë nëpër sektore në grupet e popullsisë aktive. Kështu, përkundër rastit që 77,0% e popullsisë merrej me bujqësi, grupi i popullsisë aktive në këtë degë është i paraqitur me më së 81,2%.<sup>23</sup> Ja, mjafton të ndalemi vetëm këtu dhe t'i bëjmë një vështrim kritik situatës, në mënyrë që të nxjerrim në shesh të vërtetën mbi zhvillimin përmanent agrar të kësaj komune. Pra, dominimi i popullsisë në sektorin primar është një dëshmi themelore e zhvillimit të ngadalësuar ekonomik.

Pos këtyre që përmendëm tash, ka edhe probleme të shumta siç janë, bie fjala, pjesëmarrja e madhe e popullsisë së mbajtur, e cila në vitin 1971, në krahasim me vitin 1961, jo vetëm që nuk është zvogëluar, por është shtuar për plot 9,4%. Shkaku i një gjendjeje të tillë mund të kërkohet vetëm në shtimin e madh të popullsisë dhe përfshirjen e saj në shkollim. Sidomos kohëve të fundit emancipimi i femrës dhe përfshirja e saj në shkollim është një dukuri karakteristike. Supozimin e fundit e vërteton e dhëna statistike nga e cila po theksojmë se numri i femrave aktive i popullsisë së përgjithshme në vitin 1971, ishte 15,7% do të thotë shumë më i vogël në krahasim me vitin 1961, ku shkalla e së cilës në popullsinë e përgjithshme arrinte në 27,5%.<sup>24</sup>

Vetëm klasifikimi i popullsisë nëpër sektore, jep një pasqyrë më të qartë mbi gjendjen e strukturës ekonomike të kësaj komune, nga e cila shohim se 76,9% e popullsisë aktive është koncentruar në sektorin primar: bujqësi dhe pylltari<sup>25</sup> dhe, menjëherë pas këtij sektori vjen veprimtaria kulturele dhe sociale, e cila ka tubuar, 4,3% të popullsisë aktive, pastaj ndërtimtaria me 4,2%, veprimtaria e organeve shtetërore 1,5%, xehtaria dhe industria së bashku 1,4%. Të gjitha të dhënat janë të regjistrimit të fundit (1971).<sup>26</sup> Pa u thelluar në veprimtarinë sekondare të degëve ekonomike, të cilat janë të shumta dhe të dorës së dytë, dhamë karakteristikat kryesore të tipit ekonomik për këtë komunë. Pra, është kryesisht një komunë agrare, me pak industri të zhvilluar (në një masë të vogël industria e drurit). Ajo që është karakteristika kryesore e kësaj komune është pjesëmarrja e madhe e popullsisë aktive në veprimtarinë joprodhuese. Ky është një problem i ndarjes së punës dhe i marrëdhënieve në pro-

<sup>22</sup> Stanovništvo SR Srbije prema ekonomskim obilježima, Beograd septembar, 1972, f. 53. Po aty, f. 55.

<sup>23</sup> Vepra e cituar, f. 16.

<sup>24</sup> Po aty, vetëm se është shkoqitur vlefata prej numrit absolut.

<sup>25</sup> Stanovništvo SR Srbije prema ekonomskim obilježima, Beograd, septembra 1972 god. f. 37.

<sup>26</sup> Po aty, f. 37/38.

dhim, i cili është duke e mundur ekonominë në zhvillimin më perspektiv të saj. Me këtë duam të theksojmë se shpërndarja e popullsisë nëpër sektore nuk është e mirëpërfillur nga se edhe sektori primar, i cili ani pse ka tubuar më se 77,0% të popullsisë aktive, nuk është i favorizuar me të ardhura buxhetore, të cilat kihin për të ofruar mundësitë më të mëdha për zhvillimin e bujqësisë intensive. Të ardhurat personale të punëtorëve të inkuadruar në sektorin e tretë apo të katërt janë shumë më të larta se të atyre që janë të inkuadruar drejtpërdrejt në procesin e prodhimit.


Tabela nr. 7.<sup>27</sup> Struktura ekonomike e popullsisë, e ndarjes sipas sektoreve dhe e shprehur në përqindje për vitet 1961, 1971

Vendi	Veprimtaria sipas sektoreve				
I S T O G U		I Primar	II Sekondar	III Terciar	IV Kuartar
	1961—	87,5	3,8	0,8	3,3
	1971—	77,0	7,4	1,7	5,9
Indeksi	76,9	166,2	173,1	137,2	
Përq. (%)	—20,2	66,2	73,1	37,2	

Nga të dhënat tabelare mund të caktojmë edhe tipin e strukturës ekonomike, i cili është I-IV-II-III. Dominimi permanent i sektorit primar, pastaj dominimi i sektorit kuartar mbi atë sekondar dhe terciar, në tipin e strukturës ekonomike, është karakteristikë e zhvillimit ekstensiv të vendit. Zhvillimin e pakët të industrisë, si njerës prej degëve më të rëndësishme ekonomike, e tregon pjesëmarrja e vogël e popullsisë aktive të inkuadruar në këtë veprimtari, vetëm 5,6% (1971). Këtu lypset të theksohet pjesëmarrja e madhe në sektorin kuartar, të popullsisë aktive, me 7,3% dhe të veçojmë këtë si njërin ndër momentet më të pavolitshme për strukturën ekonomike. Është kështu dhe s'mund të jetë ndryshe, nga se themelin e zhvillimit ekonomiko-shoqëror, si bazë të zhvillimit ekonomik, nuk mund ta gjejmë në sektorin kuartar, pasi dihet se ky sektor përfshin masën e fuqisë punëtore të inkuadruar në vendet joprodhuese, por në sektoret që janë të lidhura drejtpërdrejtë me procesin e prodhimit, mirëpo kurrësi si të izoluar nga veprimtaritë e shërbimit të gjerë shoqëror. Me këtë nuk kemi për qëllim të zvogëlojmë rëndësinë e aktiviteteve nëpër sektoret e tjerë, vetëm përcaktimin e ndikimit pozitiv në zhvillimin e mirëfilltë e më të shpejtuar të ekonomisë. Gjendja nëpër sektore nuk është stabile; ajo ndryshon krahas me transformimet shoqërore (shih grafikoni nr.5). Pra, e ardhmja është më inkurajuese dhe na bën më optimistë, sepse ndarja me plan e punës, organizimi vetëqeverisës, automatizimi në punë, masat teknike

<sup>27</sup> Rezultatet e fundit. . . 1971, f. 51, 53, të përpunuara nga autori.

dhe mjetet e përsosura, janë duke u zbatuar dita ditës edhe më tepër, e që bëjnë lirim të fuqisë punëtore nga puna e tepërt fizike dhe pa rezultate të mëdha dhe shtojnë produktivitetin dhe kualitetin e prodhimeve, duke krijuar një bazë më të mirë të ekonomisë së kësaj komune.



### Struktura arsimore-kulturale

Duke studjuar në tërësi superstrukturën e një vendi dhe, në veçanti ecuaritë strukturale, qofshin ato demografike apo ekonomike-kulturale, epërsia prioritare, në bazë të së cilës pritet edhe perspektiva e një shoqërie, i jipet strukturës arsimore-kulturale. Me një fjalë, faktit në çfarë niveli është zhvillimi ekonomik-shoqëror. Baza demografike me komponentet e saj, niveli i kontrollimit të shtimit natyral, kushtet higjeniko-medicinale dhe botëkuptimi etj. varet edhe prej shkallës së ngritjes arsimore-kulturale dhe shkencore. Meqë ky është një proces, i cili është i varur prej momentit kohor, krahas rrethanave të tjera politiko-shoqërore, ne do bëjmë një vështrim më tepër komparativ, duke pasur ndërmend gjithnjë të kaluarën, të tashmen dhe perspektivën në të ardhmen. Mosbarazia nacionale, jeta në kushte të vështira ekonomike, pasiguria për një

jetë normale, pastaj kompromisi shoqëror, ndikimi pozitiv apo negativ i rrymave politike për përkatësi etnike, persekutimi i përkatësive nacionale në masë të madhe apo të vogël etj. janë momentet më relevante që i dhanë vulën e prapambeturisë kësaj treve, gjatë të gjitha periudhave para Luftës së Dytë Botërore. Pra trashëgimi i patemel është reflektuar edhe pas luftime mbi zhvillimin socialist dhe, në një masë, ishte një çështje negative që në një mënyrë, por pa sukses, është ndier në shumë aktivitete të organizimit dhe të zhvillimit të punës dhe të jetës shoqërore të kësaj treve. Këtë të dhënë e vërteton fakti se plot 16 vite pas çlirimit dhe ndërtimit të socializmit, kjo komunë i kishte jo më pak se 40%<sup>28</sup> të popullsisë analfabete. Gjersa dinamika e zhvillimit ekonomiko-shoqëror në kushte të barabarta për të gjitha kombësitë, shpjegohet me të dhënë statistike, nga e cila shihet se vetëm për një deçenie, dmth. gjer në vitin 1971, përqindja e analfabetëve është zvogëluar për 8%, apo ajo tash paraqet shkallën prej 32,6%,<sup>29</sup> fakt ky që nuk të kënaq, por të shpie kah supozimi se gjendja do të përmirësohet. Atë të thënë të mëparshme, e cila vë në pozitë negative momentin e trashëgimit si pasojë e kaluarës, e bën të qartë edhe shënimi, kur dihet se më shumë se 90% e popullsisë mbi moshën 65 vjeç është analfabete apo 58,6% e popullsisë në grupin moshatar 35-64 vjeç (1971).<sup>30</sup> Pra, është fjala për popullsinë që ka lindur para Luftës së Dytë Botërore. Dinamizmi i jetës shoqërore pas çlirimit ka marrë kahjen e zhvillimit të vet më intensiv. Organizimi i shkollimit të obligueshëm tetëvjeçar, hapja e rrjetës shkollore nëpër fshatra, të cilat shekuj të tërë nuk ditën shrim-lexim dhe qenë plotësisht të izoluara, pastaj organizimi i mësimi, varësisht prej mundësive reale kadrovike, në gjuhën amtare, si dhe botimi i teksteve në gjuhën amnore etj. etj., janë fill i punës së

Tabela nr. 9.<sup>31</sup> Popullsia mbi dhjetë vjeç për nga përgatitja shkollore për vitet 1961 dhe 1971

Vendi	Viti	P r e g a t i t j a s h k o l l o r e				
		Me fakultet	SHLP	Shkolla e kuadrove të mes. prof.	Gjimnazi.	Për punëtorë të kualifikuar dhe KL.
I S T O G U		Nr. %	Nr. %	Nr. %	Nr. %	Nr. %
	1961	15 0,1	20 0,1	181 0,8	51 0,2	91 0,4
	1971	54 0,2	113 0,4	524 1,8	337 1,2	201 0,7
	Indeksi	360,0	565,0	298,5	660,8	220,9
Shkolla fillore		Me 4. kl.	Pa përgat. shkollore	Pa të dhëna	Numri i përgjithshëm	
Nr. %		Nr. %	Nr. %	Nr. %	Nr. %	
997 4,3		3321 35,8	13585 54,4	8 0,0	23269 100,0	
3798 13,4		11014 38,8	12304 43,3	61 0,2	28406 100,0	
380,9		132,4	90,6	762,5	122,1	

<sup>28</sup> Rezultatet e fundit. . . libri i cituar, f. 41.

<sup>29</sup> Po aty, f. 43.

<sup>30</sup> Po aty, f. 41, 43.

<sup>31</sup> Rezultatet e fundit për popullsi dhe për ekonomitë familjare sipas komunave për vitet 1961, 1971, EKS, Buletini 1. Prishtinë f. 43.

mbarë që është kurorëzuar me rezultate të kënaqshme. Një ecuri të ngritjes arsimore, kulturele mund të përcjellim më së lehti në bazë të shënimeve statistike, ndonëse ato janë vetëm një vleftë relative. Përsosja e kuadrit me profile të ndryshëm, sidomos në decenien e fundit, ishte mjaft intensive. Këtë e vërejmë më së miri në të dhënat statistike (shih tab.nr.9), në të cilën vërehet se shkalla e shtimit, e shprehur në indeks, është mjaft e lartë, veçmas ajo e profilit të mesëm dhe të lartë. Indeksi i shtimit të profilit me gjimnaz të kryer mes 1961-1971 ishte 660,8, me shkollë të lartë pedagogjike 565,0 kurse me fakultet 360,0. Kjo është edhe një dëshmi, e cila vërteton rrugën e drejtë të zhvillimit të arsimit me tendenca gjithnjë më të mëdha të përsosjes maksimale kualifikuese. Perspektivën e një ecurie më stabile dhe më të gjerë në të ardhmen e favorizon numri i madh i fëmijëve, të cilët tash gjenden në fazën parashkollore e që në të ardhmen do të jenë një vërshim i tërë mbi procesin mësimor, edukativ dhe kualifikues. Padyshim, një ecuri e tillë drejt shkollimit të përgjithshëm trason më së miri rrugën e vet stabile, nëse ajo gjen mundësitë materiale dhe mirëkuptimin shoqëror. Intencat e fundit të kjo popullsi janë dhënë për përmirësimin e gjendjes në këtë fushë. Mirëpo, rezultatet e dhëna nuk janë të mjaftueshme, porse rruga e synimit të drejtë na bën të jemi optimist, duke shpresuar në një të ardhme më të mirë.

Krahas me ngritjen arsimore, edhe në strukturat e tjera të popullsisë po bëhen transformime të dukshme. Kjo do thotë se është ndier varësia dhe ndikimi reciprok i kësaj strukture mbi të tjerat dhe posaçërisht mbi ecuritë demografike të popullsisë, ku dita ditës është duke u zvogëluar shkalla e natalitetit, e njëherit edhe e mortalitetit, e që janë vetëm si rezultat i kontrollimit të shtimit natyral apo rrjedhim i ngritjes arsimore-kulturele të popullsisë.

### **Struktura nacionale e popullsisë**

E kaluara historiko-politike e kësaj treve që shumë e bujshme, kështu që la vazhden e saj për një kohë të gjatë në marrëdhëniet e kombeve e të kombësive të kësaj komune. Gërshetimi i shumë lëvizjeve mekanike me karakter të ndryshëm, ekonomik, politik apo edhe të vetëdëshëruar (që kanë qenë raste të rralla emigrimet e lira), si para Luftës së Parë Botërore, gjatë saj dhe mes dy luftërave botërore, janë faktori kryesor i krijimit të popullsisë heterogjene, shikuar në aspektin nacional. Pra, kemi të bëjmë me një popullsi shumënacionale, e cila banon në këtë trevë nëpër periudha të ndryshme, kohë pas kohe. Vetë pozita gjeografike, pasuritë natyrore të përshtatshme për shfrytëzim, klima dhe hidrografia, ishin elementet kryesore, të cilave ua kishin lakmi imigrantët e jashtëm që erdhën në këto vendbanime të kësaj treve, qoftë të shtyrë prej dëshirës personale apo dirigjimit nga qarqet sunduese, të cilat kishin për qëllim konsolidimin e një shteti njënacional, mosnjohjen e të drejtave të kombeve të tjera, zhdukjen e tyre si pakica kombëtare etj. Kjo është karakteristika e përgjithshme e sistemit borgjez serb para Luftës së Dytë Botërore.

Në periudhën e kaluar ishin të pranishme dy rryma të lëvizjeve mekanike të popullsisë: emigrimi dhe imigrimi. Më të shpeshta dhe me vlerë më të madhe transformimi ishte imigracionet. Ato shkaktuan gërshetimin e kombeve dhe të kombësive në një areal relativisht të ngushtë gjeografik. Emigrimin e popullsisë, në periudhën e përmendur, e përbënte kryesisht popullsia shqiptare, së

cilës u dedikohej me plan dhe mjeshtri bindja, gjoja për „vendin ëmë” të saj, Turqinë, ku do të shpërngulej ajo. Ashtu edhe ngjau me një masë të madhe të popullsisë. Kulminacioni i emigrimit të kësaj mase u arrit rreth viteve 1936/37, por dukuri të tilla pati edhe para dhe pas këtyre viteve. Atëbotë u shpërngul një masë e popullsisë e pavetëdijshme, e pashkollë, e zhytur në fe, që s’diti të çmojë komb e atdhe, duke mos e kuptuar apo në masën më të madhe, duke iu nënshtruar presionit politik të atëherëshëm. Shpërngulje të atilla ka pasur edhe pas çlirimit, ashtu siç ka pasur edhe imigrime. Mirëpo, prej të parave i dallon vetë momenti i nxitjes për lëvizje, sepse këto bëhen në rrethana ekonomike më të mira, në periudhën e lirë për vetëvendosje dhe, faktori ndikues për migrim tash është i varur drejtpërdrejt prej personit, i cili vjen apo shpërngulet. Në të vërtetë, shpresat për një jetë më të mirë në vendin e ribanuar, për një ngritje më të lartë arsimore, për një afërsi në mes njerëzve etj., janë momente primare të kësaj dukurie që ndodh tash.

Si ruezultat i të gjitha atyre që përmendëm deri më tash është përbërja shumënacionale, e cila në këtë komunë numron në një masë më të madhe më së gjashtë pakica kombëtare: shqipëtarët, serbët, malazezët, muslimanët, turqit, romët etj. Struktura nacionale dhe ndryshimet mund të përcillen në mënyrë më të qartë në tabelën nr. 10.

Tabela nr. 10.<sup>32</sup> Struktura nacionale e popullsisë sipas regjistrimit 1961, 1971

Vendi	Shqipëtarë		Serbë		Malazezë		Muslimanë		Romë		Turq		Të tjerë	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
1961	19067	56,4	9097	26,9	3804	11,3	881	2,6	..	..	803	2,4	127	0,4
1971	27371	66,7	8944	21,8	2420	5,9	1876	4,6	243	0,6	39	0,1	116	0,3
In-deksi	143,6		98,3		63,6		212,9		—		4,9		67,7	

Të dhënat na çojnë drejt një supozimi se, në komunën e Istogut, popullsia nuk është stabile në vendin ku jeton, por gjithnjë është në lëvizje. Shpërnguljet mekanike të popullsisë, apo edhe vetë dinamika demografike e saj, pastaj vitaliteti etj., qendrojnë joproportionalisht mes grupeve etnike. Këtë e justifikon fakti se në strukturën nacionale të popullsisë bëhen ndërrime mjaft të mëdha në pikëpamje të numrit të banorëve. Kështu, në vitin 1961 popullsia serbe paraqiste 26,9% të popullsisë së përgjithshme, kurse deri në vitin 1971 ajo zvogëlohet në mënyrë rapide, qoftë nga lëvizjet mekanike apo natyrale dhe, tash paraqet vetëm 21,8% të popullsisë së përgjithshme (1971). I njëjti rast është edhe me popullsinë malazeze, e cila në dekadën e fundit ka pësuar depopullacion intensiv, në masën e saj demografike dhe, kështu humb numrin e banorëve prej 11,3% sa ka pasur në vitin 1961, në popullsinë e përgjithshme,

<sup>32</sup> Si në fusnotën 30, f. 37.

në 5,9%, në vitin 1971.<sup>33</sup> Rast të depopullacionit paraqet edhe pakica etnike turke, shikuar në momentin e parë, mirëpo, këtu kemi të bëjmë me një rast specifik, ku numri i banorëve si pjesëtarë të kësaj pakice në vitin 1971 zvogëlohet, por popullsia ngel edhe më tutje në këtë trevë, duke u deklaruar si përkatësi tjetër etnike. Pra, në këtë rast nuk kemi të bëjmë as me lëvizjen mekanike të popullsisë e as me shtimin negativ natyral, por me deklarimin e kundërt nga ai i regjistrimit të vitit 1961. Ky është rezultat i regjistrimit të fundit të popullsisë, i cili ishte më i qartë, më i lirë, më i përgjithshëm, në krahasim me të kaluarat. Ja këtu, pra, e ka burimin pjesëmarrja më e vogël në popullsinë e përgjithshme, përkatësia nacionale turke, në vitin 1971, në krahasim me atë 1961. Gjersa te tri përkatësitë etnike të përmendura më parë, ishte prezente shkalla e zvogëlimit të popullsisë, të popullsia muslimane dhe ajo shqiptare, ngjau e kundërta. Por, prapë shtimi ekspansiv i këtyre grupeve etnike është si rezultat i dy proceseve të kundërta. Shtimi i popullsisë shqiptare është rezultat i ekspansionit biologjiko-demografik, gjersa ai i popullsisë muslimane, është shtim i eksplozionit mekanik (imigrimit), që natyrisht edhe shkalla e shtimit natyral është pozitive. Mirëpo, shkalla e shtimit të përgjithshëm, e verifikuar me regjistrim, është më e lartë nga ajo e shtimit natyral, që do thotë se shtimi i popullsisë muslimane në këtë trevë është i tipit të veçantë imigrues. Indeksi i shtimit të përgjithshëm i kësaj përkatësie etnike, në decenien e fundit, ka tejkaluar përmasat e të gjitha përkatësive të tjera etnike, duke arritur shkallën prej 212,9, apo pjesëmarrjen e saj me 4,6%, në tërë popullsinë.<sup>34</sup> Tempoja e shtimit të popullsisë muslimane nuk do të ndalet gjersa të pushojë shpërngulja e popullsisë serbe e malazeze nga kjo trevë. Pra, shikuar parimisht, emigrimi i serbëve dhe i malazezëve është duke u zëvendësuar me imigrimin e popullsisë muslimane, e cila lëshon vendbanimet e saj të përherëshme, Sanxhakun, apo edhe disa vise të tjera të Malit të Zi, të shumtën rrethinën e Bellopojës, Prijepolës, Plavës dhe Gucisë.

Paraqitja me të madhe në decenien e fundit, e këtyre dy komponenteve, imigrimit dhe emigrimit, në këtë komunë, pasi janë gati të nivelizuara, nuk janë shprehur negativisht në shkallën e shtimit të përgjithshëm të popullsisë, vetëm se kanë bërë transformime në strukturën nacionale. Shtimi ekspansiv i popullsisë shqiptare, veçmas gjatë decenies së fundit, është si rezultat i shkallës së lartë të shtimit natyral, biodinamikës dhe vitalitetit. Indeksi i shtimit mesatar 143,6 në vit dhe, dominimi numerik i kësaj mase etnike mbi të tjerat përkatësi etnike, me 66,7% të popullsisë së përgjithshme, është dëshmi e stabilitetit demografik të këtij regjioni të ngushtë komunal.

Përkundër heterogjenitetit nacional, në popullsinë e përgjithshme të komunës, ekziston edhe homogjeniteti etnik, por, vetëm nëpër disa fshatra si tërësi rurale në kuadër të kësaj treve. Në radhë të parë, si një ndër fshatrat më homogjene në aspektin nacional, të banuara vetëm prej një përkatësie etnike-shqiptarëve, mund të veçojmë: Trubuhovcin me 685 banorë, Llugat me 450 banorë dhe Zabllaqin me 383 banorë, prej të cilëve vetëm një është malazez. Gjersa vendbanim të banuar vetëm me popullsi serbe nuk ka, me përjashtim të fshatit Tuçep, i cili ka 409 banorë, prej të cilëve 395 janë serbë dhe, 14 mala-

<sup>33</sup> Si në fusnotën 31.

<sup>34</sup> Po aty.

zezë.<sup>35</sup> Në përgjithësi në 50 fshatrat e kësaj komune, dominon popullsia shqiptare mbi pakicat e tjera kombëtare. Këtë e vërteton fakti se, më tepër se 33 fshatra të kësaj treve, kanë më shumë se 65% të popullsisë me përkatësi shqiptare. Përjashtim bën qendra komunale, Istogu, të cilën e banojnë 3473 banorë,<sup>36</sup> prej të cilëve 51,0% janë shqiptarë, 45,2% serb e malazezë, 3,7% romë dhe 0,1% të tjerë.<sup>37</sup> Koncentrimi më i madh i popullsisë serbe, malazeze dhe rome në këtë vendbanim gjysëmurban, është si rezultat i urbanizimit gradual e perspektiv, kurse dominimi i njërës apo tjetrës përkatësi etnike nëpër vendbanimet rurale, është rezultat i dyndjeve të popullsisë në të kaluarën dhe tash.

Karakteristikë e gjithë asaj që është thënë deri më tash për strukturën nacionale të kësaj treve është më sa vijon:

— heterogjeniteti nacional është rezultat i rrethanave ekonomike-politike dhe shoqërore,

- i shkallës së shtimit natyral`jo të barabartë,
- i rrymave mekanike (migracioneve),
- i momentit etno-psikologjik, si faktor emigrues,
- i eksodusit rural etj.

Dinamizmi i jetës shoqërore në të gjitha veprimtaritë socio-ekonomike, gradualisht dhe vetvetiu është duke ndikuar mbi përmirësimin dhe stabilizimin e kësaj strukture. Mirëpo, derisa potencojmë stabilizimin e kësaj strukture, është e nevojshme të shtojmë se kontinuiteti nacional, që ishte krijuar kohë pas kohe në mes të disa nacionaliteteve të kësaj komune, tashmë po ndërrohet strukturën e vet, duke bërë zëvendësimin e një grupi etnik me tjetrin (rasti është theksuar më lart) dhe kështu, struktura nacionale, e përbërë prej shumë grupeve etnike ekziston edhe më, vetëm se është modifikuar me një përkatësi të re etnike, me muslimanë. Vendbanimet, në të cilat është rasti më aktual, janë Dobrusha dhe Lubova, por gjithashtu ka dukuri edhe në shumë fshatra të tjera. Gjithkund ku është prezent emigrimi i serbëve dhe i malazezëve, paraqitet imigrimi, të shumtën i muslimanëve, por jo gjithëherë. Pra, ka raste kur pasurinë e tyre e blen fqiu i tij, apo miku, apo, aty vjen edhe ndonjë pjesëtar i grupit tjetër etnik, jo musliman.

### **Karakteristikat etno-sociale dhe demografike të familjes**

Familja si qelizë themelore e shoqërisë, meriton një studim të tërësishëm dhe rrënjësor si: në aspektin ekonomik, psikologjik, etnik, arsimor, kultural, historik, zakonor etj. Ndikimi i problemeve që lindin në gjirin e saj dhe gërshtimi i tyre me një sër faktorësh të tjerë shoqërorë, shton edhe më tepër rolin e saj në shoqëri dhe nevojën për studim. Mjerisht, trajtimi i saj dhe studimi shkencor i kësaj kategorie shoqërore, sikundër edhe tërë popullsisë dhe strukturave të saj shoqërore, ka munguar në këtë trevë, ashtu siç ka ngjarë për pje-

<sup>35</sup> Rezultatet e para të regjistrimit të popullsisë, KSAK, Enti Statistikor Krahinor, Prishtinë, 1971, f. 13, 14.

<sup>36</sup> Po aty.

<sup>37</sup> Po aty.

sën më të madhe të Kosovës. Pra, kjo fushë e gjerë dhe e paprekur mbetet temë prioritare për një studim shkencor nga ekspertët e interesuar për kontribut në këtë lëmë të jetës.

Meqë popullsia e kësaj komune gjendet në fazën e transformimeve më intensive shoqërore, qoftë në bazën materiale apo shpirtërore të popullsisë, nevoja është aq më e madhe për një nxitim sa më të shpejtë studjues, në mënyrë që kultura, e mbarë thesari i këtij populli, të grumbullohet në ngjyrën dhe shijën e tij origjinale, të pamodifikuar. Pra, të shpëtohet prej fshirjes së dinamizmit bashkëkohor.

Familja si qelulë shoqërore, qenësore, në trevën e kësaj komune ka një historik të kuptimit të termit të saj. Populli me fjalën familje kuptonte, dhe ende kupton, një grup njerëzish, të cilët janë të një gjaku (barku), që jetojnë së bashku, punojnë së bashku dhe rezultatet e punës i ndajnë së bashku. Meqë jeta e tyre zhvillohet në një lokal shtepiak (nën një kulm) të përbashkët, atëherë populli shpesh zë në gojë edhe termin „shtëpi”, me të cilin kuptohet e njëjta bashkësi, familja. Në të kaluarën, nuk kanë qenë të rralla rastet ku janë përdorur termat „tym” dhe „zjarr”, të cilët poashtu kanë pasur të njëjtin kuptim, pra atë të *familjes*. Mirëpo, koha gradualisht i ka shlyer dhe, në vend të tre termave të dikurshëm „tym”, „zjarr” dhe „shtëpi”, sot në popull më së shpeshti përdoret termi i ri *familje*, ndonëse akoma hasim edhe termin „shtëpi”, zakonisht te familjet që u përkasin kryesisht kategorive të familjes bujqësore apo blegtorale.

Familjet në këtë komunë mbajnë mbiemra fisesh si psh: Berishë, Gash, Krasniq, Thaç, Morinë etj. pastaj emrin e ndonjë të pari të tyre si: Murselaj (sipas emrit Mursel), Sadikaj (Sadikut), Sylaj (Sylës), Metaj (Metës), Tahiraj (Tahirit) etj. por, ka edhe mbiemra familjesh, të cilët bazohen në fshatrat ku kanë banuar më parë, p. sh: Rugova (Rugove, këtu ka kuptimin e një regjioni më të gjerë (gjeografik), Pepaj (sipas fshatit Pepiç), Bicaj (fshati Bicaj), Dreshaj (fshati Drela; Rugovë) etj. Natyrisht se hasim edhe mbiemra të tjerë, sipas vepërimtarisë (punës) si: Kovaç, Kerraç (mjeshtër të qerreve) etj.

Është interesant se familjet në vendbanimet e kësaj komune, në shumë raste janë të grumbulluara në lagje, mëhallë, kuptohet pasi të ndahen, dhe këstu formojnë një tip të veçantë vendbanimesh. Rastet e tilla janë të shpeshta, p. sh. në fshatin Vrellë hasim një sërë mëhallësh të krijuara prej një grumbulli familjesh si: mëhalla e Bicaj, Blakaj, Dreshaj, Maxharraj etj. apo në fshatin Shushicë mëhalla Metaj, Alidemaj e Ibroshëve etj. etj. Pra, nga kjo shohim se vendbanimet e fshatrave të përbëra prej disa familjeve u takojnë në të njëjtën kohë edhe disa fiseve, gjë që dëshmon për integritetin e popullsisë prej vendeve të ndryshme (krahinave), të cilët afërsia i detyron të jetojnë në një vendbanim të përbashkët.

### **Familjet dhe ndryshimi i tyre për kah numri i anëtarëve në mes dy regjistrimeve të fundit 1961, 1971**

Marrëdhëniet shoqërore, në të kaluarën në këtë trevë, qënë kushtezuesit kryesorë të marrëdhënieve familjare, jetës së përbashkët, punës dhe madhësisë së saj. Shkalla e ulët e nivelit arësimor-kultural, në një anë, zhvillimi ekonomik i orientuar kryesisht në veprimtari agrare, në anën tjetër, dhe momentet his-

toriko-politike të së kaluarës, ishin të mërëseardhura për krijimin dhe ekzistimin e familjeve patriarkale. Prandaj, paraqitja e këtyre familjeve në këtë trevë, i ka rrënjët e veta në të kaluarën historike. Ambienti në të cilën u krijuan familje të mëdha patriarkale, me disa dhjeta e, në disa raste edhe përtej njëqind anëtarësh, ishte shumë i përshtatshëm, vend agraro-blegtoral. Këto familje ruajtën dhe humbën tipin e tyre, varësisht nga niveli i zhvillimit të përgjithshëm familjar dhe, në tërësi shoqëror. Prandaj, krahas shuarjes së këtyre familjeve, në të cilat, në dinamizmin e jetës moderne ka depërtuar arsimit dhe kultura, emancipimi i femrës dhe ndarja e punës sipas veprimtarive të shumta ekonomike jobujqësore, hasim përsëri në aso familjesh, të cilat numërojnë përtej 20 apo shpesh edhe 30 anëtarë. Ekzistimin e tyre të gjatë dhe, perspektivën minimale të zvogëlimit për një periudhë të shkurtër kohore, e arësyetojnë marrëdhëniet ekonomike, aktiviteti bujqësoro-blegtoral, niveli i ulët i arsimimit emancipimi minimal i femrës dhe, ajo që është më primare në këtë aspekt, dendësia e madhe agrare, 3,24<sup>38</sup> banorë në një ha tokë të lavruar, me pemë apo hardhi rrushi (masatarja për tërë komunën). Numri i familjeve të tilla (shumëanëtarëshe) dita ditës është gjithnjë më i vogël. Atë e zvogëlojnë të arriturat në fushën e gjerë të veprimtarive ekonomiko-shoqërore në tërësi.

Shtimin e numrit të anëtarëve të familjes e shpejtoi edhe shtimi natyral i popullsisë, sidomos tash kur familjet janë më tepër bujqësore dhe anëtarët e tyre, për shkaqe ekonomike, nuk mund të gjejnë kushte jetese më të mira në jetën e ndarë (sipërfaqet e vogla bujqësore janë shkas i kësaj). Mu nga kjo rrjedh fakti se indeksi i shtimit të përgjithshëm të popullsisë mes dy regjistrimeve të fundit (1961, 1971) ishte 121,<sup>39</sup> gjersa indeksi i shtimit të përgjithshëm të familjeve ishte 115,6.<sup>40</sup> Do të thotë se procesi i zvogëlimit të anëtarëve të familjes, ndarja, qëndron në një dinamikë më të ngadalësuar se sa shkalla e shtimit natyral e popullsisë. Numri i familjeve 4877, sa ishte në vitin 1961,<sup>41</sup> është shtuar në 5636 në vitin 1971.<sup>42</sup> Prandaj, nga kjo rrjedh edhe mesatarja e anëtarëve të familjeve për mbarë popullsinë, 7,28 frymë (1971), që kalon mesataren jugosllave (që ka 3,8 anëtarë), Sllovene (3,3) dhe atë të KSA të Vojvodinës (3,2).<sup>43</sup>

Në numrin e përgjithshëm të familjeve, dominon grupi i familjeve prej 6, 7, 8 e më tepër anëtarëshe, të cilat në tërë familjet (5636-1971) paraqesin 62,1%. Në mesin e tyre është më i dalluari grupi i familjeve mbi 8 anëtarë, që paraqet 38,4%, të tërë familjeve. Pra, dominon edhe më numri i familjeve të mëdha. Familje me tre e më pak anëtarë (1 dhe 2), ka shumë pak, 18, 6%.<sup>44</sup> Është interesant se indeksi i shtimit të familjeve të mëdha është më i madh. 129,4, për familjet që numërojnë më tepër së 8 pjesëtarë, brenda viteve 1961, 1971 dhe, më i vogël për familjet që kanë më pak anëtarë, 1,2 apo 3, vetëm 102,7.<sup>45</sup> për të njëjtën periudhë.

<sup>38</sup> ZUP, Regionalni prostorni plan SAPK, Migraciona kretanja stanovništva u SAPK, Prishtinë, mars, 1971, f. 79.

<sup>39</sup> SAPK, Konačni rezultati za stanovništvo i domaćinstva po opštinama 1961. i 1971. god. Priština, 1974. god. f. 17.

<sup>40</sup> Po aty, f. 57.

<sup>41</sup> Po aty, f. 57.

<sup>42</sup> Po aty, f. 57.

<sup>43</sup> Dr. Mark Krasniqi, *Gjurmime albanologjike — Folklor dhe Etnologji, II* — 1972, Instituti Albanologjik Prishtinë, Prishtinë, 1974. f. 45.

<sup>44</sup> Po aty, rezultatet e fundit. . . f. 59.

<sup>45</sup> Po aty, f. 57.

Kjo dukuri, është e pranishme te ato familje, që merren me bujqësi dhe blegtori (te ato me shtim të lartë) në njërin anë dhe, te ato që janë të ngritura në pikëpamje arsimore-kulturale dhe që janë të inkuadruara në veprimtaritë e sektorit të gjerë shoqëror, në anën tjetër, (me shtim të ulët).

Mirëpo, sikur të ekzistonin shënimet e kësaj natyre nëpër grupet etnike të popullsisë, atëherë, me siguri, situata do të ishte edhe më e qartë, nga se përkatësia nacionale serbe dhe malazeze dallohet për familje më të vogla, mu më pak anëtarë. Pra, situata ndryshon edhe mes grupeve etnike.

### Aktivitetet dhe pronat familjare

Familjet në trevën e kësaj komune i përkasin kryesisht kategorisë së familjeve bujqësore-fshatare. Mirëpo, pasi zhvillimi ekonomik-shoqëror në vitet e fundit ka marrë përpjestime më të gjera, duke ofruar mundësi për inkuadrim edhe në veprimtari të tjera ekonomike, të sektorit sekondar, terciar apo kuartar dhe, me krijimin e strukturës sociale të përzier, u krijuan edhe disa nënkategori<sup>46</sup> familjesh të kombinuara p.sh: bujqësore-punëtore, bujqësore-arsimtare, bujqësore-administrative, bujqësore-zejtare etj. Prandaj, edhe aktiviteti ekonomik i tyre është i ndryshëm, çka jep edhe rezultate të ndryshme në punë. Zakonisht, të ardhurat më të ulëta për kokë të anëtarit familjar, u takojnë familjeve bujqësore dhe blegtorale. Në një situatë diçka më të mirë gjenden familjet që kanë strukturë të përzier, duke realizuar të ardhura nga disa veprimtari ekonomike. Standardi jetësor është më i lartë nëpër ato familje që kanë të inkuadruar njërin prej anëtarëve të vet në industri, kulturë, arsim apo administratë, gjersa më i ulët te familjet bujqësore-agrare. Pra, pasi 60,3% e ekonomive familjare merren me bujqësi, 16,1% me veprimtari të përziera dhe 23,6% me veprimtari jobujqësore<sup>47</sup> mund të konstatojmë se pjesa më e madhe e popullsisë së kësaj treve jeton në kushte relativisht të vështira ekonomike.

Edhe më tepër të dëshpëron fakti se familjet bujqësore disponojnë me sipërfaqe tokësore jo të mjaftueshme dhe të klasësve të treta, katërta e më rrallë të së parës, në pjesën më të madhe të familjeve. Kështu, bie fjala, 35,2% të familjeve disponojnë me më pak se 2,00 ha tokë bujqësore,<sup>48</sup> gjersa nga ato që nukë kanë tokë fare janë 12,4% të familjeve. Familje që disponojnë më tepër se 8 ha sipërfaqe të tokës bujqësore ka vetëm 4,0%. Prandaj, edhe mundësitë për krijimin e tepricës së rezultateve të punës (jashtë nevojave për shpenzime familjare) janë shumë të vogla dhe, ato, nëse paraqiten, ndodhin vetëm te familjet më të pasura, të cilat kanë ekonomi të gjerë bujqësore.

Në pjesën më të madhe të familjeve, të cilat arrijnë të krijojnë tepricën e vlerave materiale dhe të konsumit, paraqitet akumulimi i atij malli në të holla, apo shpesh me atë vlerë blehen sipërfaqe të reja toke, kafshë etj. dhe kështu bëhet zgjerimi i ekonomive familjare, kurse në anën tjetër ekziston një numër familjesh, të cilat pasurinë e krijuar jashtë nevojave të konsumit njëvjeçar (e sosh ka shumë pak) e shfrytëzojnë për ngritjen e standardit jetësor.

<sup>46</sup> Po aty, Dr. Mark Krasniqi, Gjurmime. . . f. 31.

<sup>47</sup> Si në fusnotën 44, f. 61.

<sup>48</sup> Po aty, f. 65.

Sidoqoftë, familja në komunën e Istogut, në dinamizmin e jetës së re, është duke përjetuar transformime të mëdha dhe, evoluimi i saj, sado i ngadalshuar, e sjell atë në një perspektivë më të mirë, për krijimin e familjes bashkëkohore. Pra krahas transformimit të saj në aspektin numerik, duke zvogëluar numrin e pjestarëve (me ndarje), bëhet edhe ndryshimi në vetë strukturën e saj. Kjo do thotë, ka për t'u shtuar numri i familjeve që merren më tepër me veprimtari ekonomike jobujqësore, të paktën do të jenë të përziera.

*Ukë Xhemaj*

QUELQUES CARACTERISTIQUES SOCIO-FAMILIALES  
ET ECONOMICO-DEMOGRAPHIQUES DE LA COMMUNE D'ISTOG  
DES RECENSEMENTS DERNIERS ENTRE 1961 ET 1971

R é s u m é

Selon les plus récentes études économique-démographiques et socio-familiales, faites dans cette commune, en respectant toujours la méthode comparative, nous avons constaté que, cette commune possède une intensive dynamique de transformations sociales complexes

La population, un des facteurs les plus dynamiques et un des facteurs primaires pour cette contrée, a subi des changements radicaux pendant la dernière décennie dans sa structure démographique, expression de la situation socio-économique et de la situation sociale en général. Il y a eu une véritable expansion démographique de 33.779 en 1961 à 41.009 en 1971. Parallèlement à ceci, il y a eu une augmentation de la densité de la population de 74 habitants en 1961 à 93 habitants au km<sup>2</sup> en 1971. Cette augmentation démographique n'est pas occasionnelle, mais elle est liée à une série de facteurs sociaux et à des éléments naturels ayant modifié les lois biológico-démographiques dépendant du temps et de l'espace. Ceci est mieux prouvé par les composantes des mouvements naturels et par l'augmentation elle-même de la population. Ainsi, de 1957 à 1961, quand la situation économique était difficile et le niveau éducatif-culturel beaucoup plus bas en général, la natalité atteignait plus de 42,5%, tandis que la mortalité plus de 13,2%, sans parler des nouveaux-nés, dont la natalité s'élevait plus de 180% par an. Avec l'amélioration de la situation économique-sociale, en 1971, le niveau de ces deux composantes démographiques connaît une baisse considérable, la natalité s'élève à 34,3% et la mortalité à 7,6%. Nous assistons donc à une diminution du niveau de ces composantes; cependant l'augmentation de la population reste très élevée, expansive et atteint un niveau moyen annuel de 26,7%.

La dynamique expansive de l'augmentation de la population de cette contrée se reflète dans beaucoup de procès et d'activités de la vie sociale.

Résultant de l'augmentation naturelle très élevée, on a un niveau aussi très élevé dans le milieu ouvrier. Aussi le problème de la main-d'oeuvre se pose. Les possibilités minimales d'embauche, d'un côté, et l'excédent de la main d'oeuvre, de l'autre côté, ont conditionné l'immigration du meilleur potentiel de la main d'oeuvre. La bio-dynamique et la vitalité de la population de cette commune promettent encore une augmentation de la main-d'oeuvre. Une telle expansion démographique explosive, avec une nouvelle base démographique, plus de 53% de la jeune population, impose dans les rapports sociaux des activités intensives efficaces pour la création de nouveaux postes d'embauche.

On a encore constaté que cette contrée est toujours arriérée au point de vue économique. C'est une région agraire avec plus de 77% de la population active embauchée dans le secteur primaire. La fait le plus grave est l'agriculture extensive.

L'industrie n'existe presque pas (à l'exception du traitement du bois dans le combinat „Radushë”).

Les relations familiales, bien qu'elles aient évoluées au contact de la vie contemporaine, sont encore sous l'influence patriarcale (surtout celles au flanc des montagnes). Ceci est justifié par le fait que la femme n'est toujours pas émancipée et que la situation économique défavorable l'a réduite à un milieu fermé. Quoique on développe le système éducatif avec intensité, le dernier recensement (1971) n'a cependant pas donné des statistiques encourageantes, car 32% de la population reste toujours illettrée.

Quoi qu'il en soit, le dynamisme de la vie et les succès actuels vont ouvrir le chemin à de meilleurs et plus rapides réalisations dans le développement économique-social, culturel, éducatif, démographique, etc.

